

## RAPORT I MONITORIMIT

# ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023

*Këndvështrim i Sekretariatit  
të Platforma Civikos*

*Prishtinë, Shkurt 2024*

*Ky raport i monitorimit është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja është përgjegjësi e Platforma Civikos dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.*

*Raporti është realizuar në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me USAID në Kosovë. Platforma Civikos është partnere e KCSF në realizimin e këtij aktiviteti.*



## RAPORT I MONITORIMIT

# ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023

*Këndvështrim i Sekretariatit të Platforma Civikos*

*Prishtinë, Shkurt 2024*



## PËRMBAJTJA

7	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
10	HYRJE
12	METODOLOGJIA
13	I. STRATEGJIA DHE ZBATIMI I SAJ
13	Zbatimi i përgjithshëm i Strategjisë
14	I.1. Zbatimi i Objektivit Strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje
17	I.2. Zbatimi i Objektivit Strategjik 2: Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik
23	I. 3. Zbatimi i Objektivit Strategjik 3: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve publike
26	I.4. Zbatimi i Objektivit Strategjik 4: Rritja e vullnetarizmit për programet me interes publik
28	II. PUNA E KËSHILLIT PËR BASHKËPUNIM TË QEVERISË ME SHOQËRINË CIVILE
30	III. SFIDAT E PËRGJITHSHME NË ZBATIMIN E STRATEGJISË
31	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME
32	<b>SHTOJCA I. ZBATIMI I OBJEKTIVIT STRATEGJIK 1: RRITJA E PJESEMMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKË-BËRJE</b>
41	<b>SHTOJCA II. ZBATIMI I OBJEKTIVIT STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR FINANCIM NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË OShC-ve ME INTERES PUBLIK</b>
51	<b>SHTOJCA III. ZBATIMI I OBJEKTIVIT SRATEGJIK 3: ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE PËR KONTRAKTIMIN E OShC-VE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE</b>
56	<b>SHTOJCA IV. ZBATIMI I OBJEKTIVIT STRATEGJIK 4: RRITJA E VULLNETARIZMIT PËR PROGRAMET ME INTERES PUBLIK</b>



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet një përmbledhje të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023<sup>1</sup> (tutje referuar si Strategjia). Qëllimi i raportit është të vë në pah të arriturat kryesore, ngecjet dhe sfidat në zbatimin e Strategjisë, me fokus të veçantë në të arriturat përgjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, duke përmbledhur edhe të gjeturat që nga fillimi i zbatimit të Strategjisë.

Strategjia është miratuar në vitin 2019, bashkë me Planin e Veprimit, në të cilin janë përkufizuar objektivat specifike për secilën prej objektivave strategjike, aktivitetet, periudha kohore, kostoja e zbatimit, institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre, si dhe detaje tjera relevante. Qëllimi kryesor i Strategjisë është krijimi i një mjedisi më të përshtatshëm për zhvillimin e shoqërisë civile e rrjedhimisht rritja e bashkëpunimit ndërmjet Shoqërisë Civile dhe Qeverisë. Objektivat strategjike të kësaj Strategjie janë hartuar si rezultat i problemeve të identifikuara bazuar në vlerësimin e shkaqeve bazë.

Ofrimi i një pasqyre të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë bëhet duke analizuar zbatimin e aktiviteteve specifike nga ana e institucioneve përgjegjëse, dhe duke dhënë rekomandimet përkatëse, nga këndvështrimi i Sekretariatit të Civikos. Raporti është përgatitur nga Sekretariati i Platforma Civikos, me mbështetje të Programit për Angazhim Qytetar (CEA), një partneritet ndërmjet Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe USAID në Kosovë.

Ndonëse nuk karakterizohet me arritje të shumta, gjysma e dytë e vitit 2023 shënon periudhën në të cilën ka filluar puna në hartimin e legjislacionit sekondar për kontraktimin e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve, e që paraqet zhvillim përmbajtësor në aspektin e zbatimit të Strategjisë, gjegjësisht Objektivit Strategjik 3, i cili e mbulon fushën e kontraktimit të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve. Specifikisht, ky zhvillim ndikon në zbatimin e aktivitetit “Krijimi i standardeve, procedurave dhe kriterëve për rregullimin e ofrimit të shërbimeve publike nga OSHC-të”. Në dhjetor të vitit 2023 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka themeluar grupin punues për hartimin e Rregullores për Kontraktim të Shërbimeve të OSHC-ve, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të OSHC-ve.<sup>2</sup> Platforma Civikos, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në këtë proces, duke e ngritur këtë çështje tek të gjithë mekanizmat përgjegjës për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë, qoftë në Këshillin për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile apo institucionet përgjegjëse. Në këtë mënyrë, Civikos në takimet e rregullta të Këshillit si dhe nëpërmjet kanaleve tjera të komunikimit, ka theksuar nevojën për ndërmarrjen e veprimeve për rregullimin e kësaj fushe. Për më tepër, si një prej aktiviteteve kyçe në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, Civikos ka mbajtur takime dhe komunikim të rregullt me Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive të linjës, duke u angazhuar në avokim të drejtpërdrejtë për rregullim të kësaj fushe. Ky aktivitet është i rëndësishëm sepse e rregullon fushën e kontraktimit të shërbimeve dhe në këtë mënyrë siguron stabilitet për OSHC-të që ofrojnë shërbime dhe u jep mundësi më të mëdha qytetarëve që janë në nevojë për to.

Krijimi i regjistrit për pronat shtetërore të dhëna në shfrytëzim për OSHC-të tashmë është përfshirë si pjesë e procesit të avancimit të platformës e-Komuna<sup>3</sup>, proces për të cilin ende janë duke u

<sup>1</sup> Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës. 2019. Platforma Civikos. Linku në tri gjuhët: [http://www.Civikos.net/repository/docs/Strategy\\_Alb\\_815880.pdf](http://www.Civikos.net/repository/docs/Strategy_Alb_815880.pdf)

<sup>2</sup> Takimi i parë i grupit punues është mbajtur në muajin dhjetor. Aktivitetet e grupit punues realizohen nga Platforma Civikos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë, në kuadër të projektit Human Rightivism, i mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë, përmes Fondit për Zhvillim Komunitar (CDF).

<sup>3</sup> Platforma e-Komuna është iniciativë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që synon të krijojë një hapësirë interaktive që nxitë transparencën, llogaridhënien dhe rritjen e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, duke rritur njëkohësisht efikasitetin e shërbimeve vendore. Kjo platformë do të fokusohet kryesisht në monitorimin e Kuvendeve Komunale dhe Ekzekutivit të Komunave si nivele kyçe të organeve komunale.

zhvilluar procedurat përkatëse nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Kjo ndikon në zbatimin e aktivitetit “Zhvillimi i regjistrit elektronik të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim të OSHC-ve”. Ky regjistër është i rëndësishëm sepse përmes tij synohet që të përmbledhen në një vend të veçantë të dhënat për pronat që secila komunë jep në shfrytëzim për OSHC-të dhe në këtë mënyrë sigurohet informim i drejtë dhe i qartë i palëve të interesit nëpërmjet një qasjeje të lehtësuar në këto të dhëna.

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit janë realizuar edhe trajnime, si vazhdimësi e aktiviteteve të realizuara gjatë periudhave të kaluara të monitorimit. Në muajin shtator 2023, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) bashkë me MAPL ka realizuar trajnimin “Konsultimi publik në komuna dhe procesi i publikimit në platformën për konsultime publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës”.

Po ashtu, KCSF dhe organizata TOKA kanë finalizuar hulumtimin mbi vullnetarizmin në Kosovë. Në periudhën vijuese do të identifikohen mundësitë për promovim dhe angazhim në vullnetarizëm dhe do të diskutohen me palët relevante. Raporti përmbanë rekomandime mbi përmirësimin e vullnetarizmit në Kosovë e rrjedhimisht do të kontribuojë në zbatimin e aktivitetit “Hartimi i koncept dokumentit mbi vullnetarizmin”.

Përveç aktivitetit që mbulon fushën e kontraktimit të OSHC-ve, i cili tashmë karakterizohet si aktivitet në proces të zbatimit dhe konsiderohet si arritje mjaft e madhe, ngecjet mbesin të njëjta me ato të periudhës paraprake të monitorimit të zbatimit të Strategjisë. Sa i përket Objektivit Strategjik 1, ndonëse shumica e aktiviteteve janë zbatuar, ngecjet mbesin në aktivitetet që ndërlidhen me rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për procesin e konsultimeve publike dhe rekrutimin e zyrtarit për koordinim të procesit të konsultimeve publike. Po ashtu, edhe pse një strategji e komunikimit me publikun mbi platformën online dhe standardet e konsultimeve publike është përgatitur, një dokument i tillë nuk është publikuar ende, dhe për këtë nuk është marrë ndonjë informatë se pse nuk është bërë. Në lidhje me Objektivin Strategjik 2, ngecjet mbesin në fusha të rëndësishme si rregullimi i fushës së filantropisë, dhe krijimi i mekanizmave dhe standardeve për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve. Edhe për këto aktivitete nuk ka informata në lidhje me arsyet se pse nuk janë realizuar deri më tani. Lidhur me Objektivin Strategjik 3, ngecjet që evidentohen kanë të bëjnë me hartimin e udhëzuesit për kontraktimin e shërbimeve bazuar në kornizën ligjore, si dhe krijimin e databazës së organizatave që ofrojnë shërbime. Po ashtu, rregullimi i aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve është një prej aktiviteteve për të cilat ende nuk janë dhënë informata lidhur me procesin. Rregullimi i vullnetarizmit si fushë e përfshirë në kuadër të Objektivit Strategjik 4 mbetet po ashtu një prej ngecjeve, duke përfshirë këtu hartimin dhe aprovimin e koncept dokumentit për vullnetarizmin dhe implementimin e rekomandimeve të tij. Gjithashtu, lansimi i skemës së granteve për zhvillimin e kapaciteteve për OSHC-të për këtë fushë, përgatitja e manualit për rekrutimin dhe menaxhimin e vullnetarëve janë ngecje të evidentuara të cilat nuk kanë arritur të zbatohen si rezultat i moszhvillimit të legjislacionit për këtë fushë. Zhvillimi i fushatës për rritjen e njohurive për vullnetarizmin dhe përmirësimi i mëtutjeshëm i regjistrit online për vullnetarët po ashtu nuk janë zbatuar plotësisht dhe edhe për to nuk ka informata të detajuara lidhur me arsyen e moszbatimit.

Që nga fillimi i zbatimit të Strategjisë, Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile ka punuar në evidentimin e ngecjeve në zbatimin e objektivave të Strategjisë si dhe në rekomandimin e hapave për rritjen e zbatimit të saj. Rrjedhimisht, koordinatorët e ekipeve të Këshillit dhe anëtarët tjerë kanë ngritur çështjet apo problemet kryesore të hasura gjatë punës së tyre të përditshme, të cilat ndërlidhen me objektivat e Strategjisë.


Sikurse ngecjet, edhe sfidat kryesore të identifikuar që kanë ndikuar në moszbatimin e Strategjisë mbesin pothuajse të njëjta me ato të periudhës paraprake të monitorimit. Ndër sfidat që po vazhdojnë ta afektojnë zbatimin e Strategjisë janë: mospjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit në takimet e rregullta dhe aktivizimi jo i madh i Këshillit në procesin e zbatimit të Strategjisë, pastaj mungesa e ndarjes së mjeteve buxhetore për aktivitetet e planifikuara me Strategji e po ashtu edhe mungesa e kapaciteteve njerëzore të ZQM-së. Këto sfida dhe sfidat tjera (të elaboruara në



kapitullin e veçantë mbi sfidat) e kanë karakterizuar procesin e zbatimit të Strategjisë që nga fillimi i saj e deri në këtë periudhë të monitorimit.

Rekomandimet kryesore të dala nga ky raport janë: Institucionet përgjegjëse për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë të jenë më aktive në procesin e zbatimit të Strategjisë; Këshilli të jetë më aktiv në përcjelljen e zbatimit të aktiviteteve nga ana e institucioneve; Qeveria e Republikës së Kosovës të ndajë buxhet për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë sipas obligimeve të marra me Strategji; Të rritet kapaciteti i resurseve njerëzore të ZQM-së në mënyrë që të sigurohet zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë.

Detajet tjera rreth progresit të zbatimit të Strategjisë deri në fund të vitit 2023, e që paraqet edhe kohën e përfundimit të Strategjisë, janë të paraqitura në infografikën e mëposhtme.



Infografika 1: Niveli i zbatimit të Strategjisë deri më 31 dhjetor 2023

## HYRJE

Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 përbëhet nga 4 objektiva strategjike të cilat janë të ndara në 14 objektiva specifike dhe 48 aktivitete (të paraqitura në infografikën në vijim).

Objektiva Strategjike

01

### Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje

- **Objektivi specifik 1.1**  
Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultimet me publikun;
- **Objektivi specifik 1.2**  
Ngritja e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike;
- **Objektivi specifik 1.3**  
Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike.

Objektiva Strategjike

02

### Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik

- **Objektivi specifik 2.1**  
Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OShC-ve;
- **Objektivi specifik 2.2.**  
Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave;
- **Objektivi specifik 2.3.**  
Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të;
- **Objektivi specifik 2.4.**  
Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të financuara nga BE-ja.

Objektiva Strategjike

03

### Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve publike

- **Objektivi specifik 3.1.**  
Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OJQ-ve;
- **Objektivi specifik: 3.2.**  
Përmirësimi i njohurive të institucioneve rreth mundësive (modeleve) ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve;
- **Objektivi specifik 3.3.**  
Mbledhje dhe publikim sistematik i informatave mbi potencialin e OShC-ve për të ofruar shërbime publike për institucionet publike;
- **Objektivi specifik 3.4.**  
Përmirësimi i legjislacionit që rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të.

Objektiva Strategjike

04

### Rritja e vullnetarizmit për programet me interes publik

- **Objektivi specifik 4.1.**  
Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik;
- **Objektivi specifik 4.2.**  
Zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët;
- **Objektivi specifik 4.3.**  
Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit.

Infografika 2. Objektivat strategjike dhe objektivat specifike

Strategjia i priorizon fushat në të cilat duhet të ndërmerren aktivitetet nga ana e institucioneve, me qëllim të krijimit të një mjedisi më të përshtatshëm për zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet Shoqërisë Civile dhe Qeverisë. Rrjedhimisht qytetarit i ofrohet mundësi që të jetë pjesë e proceseve vendimmarrëse, pastaj transparencë në procesin e financimit publik të OSHC-ve, sistem i ndërtuar të ofrimit të shërbimeve dhe mjedis i përshtatshëm i zhvillimit të punës vullnetare. Moszbatimi i aktiviteteve të Strategjisë rezulton në mungesë transparence dhe mospjesëmarrje të qytetarit e rrjedhimisht Shoqërisë Civile në proceset më të rëndësishme të cilat e afektojnë jetën e secilit qytetar.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë, përveç që jep një pasqyrë të qartë të aktiviteteve që janë realizuar deri më tani, identifikon edhe aktivitetet që nuk janë zbatuar. Duke qenë se raporti paraprakisht konsultohet me Këshillin dhe me institucionet përgjegjëse, efekti i tij reflektohet në drejtim të rritjes së zbatimit të Strategjisë. Pra, raporti jep një pasqyrë të progresit të zbatimit të Strategjisë për institucionet, Shoqërinë Civile dhe qytetarin në përgjithësi, dhe jep rekomandimet për rritjen e zbatimit të saj. Platforma Civikos ka realizuar monitorimin e zbatimit të Strategjisë, për periudhën korrik - dhjetor 2023, duke përmbledhur edhe të gjeturat në zbatimin e Strategjisë që nga fillimi i këtij procesi.

Në pjesën e parë të raportit është paraqitur një përshkrim i shkurtër i zhvillimeve rreth Strategjisë, duke vazhduar më pas me përshkrimin për metodologjinë e përdorur për monitorimin e zbatimit të objektivave të Strategjisë. Në kapitullin e parë, fillimisht është paraqitur zbatimi i përgjithshëm i Strategjisë, për të vazhduar me paraqitjen e gjetjeve për të arriturat dhe ngecjet për aktivitetet dhe objektivat specifike të secilës nga katër objektivat strategjike. Kapitulli i dytë i dedikohet punës së Këshillit si dhe grupeve tematike të themeluara nga Civikos<sup>4</sup>. Ndërsa, në pjesën e fundit janë përmbledhur sfidat që kanë ndikuar në moszbatim të Strategjisë dhe rekomandimet për veprim të mëtutjeshëm në këtë drejtim.

---

4 Grupet tematike janë themeluar bazuar në katër objektivat strategjike të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA), një partneritet ndërmjet Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe USAID në Kosovë.

## METODOLOGJIA

Ky raport paraqet një përmbledhje të monitorimit të zbatimit të Strategjisë për periudhën korrik - dhjetor 2023. Platforma Civikos, gjatë vitit 2022 kishte publikuar raportin e parë të monitorimit të zbatimit të **Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023**. Duke qenë se monitorimi i zbatimit për këtë Strategji nga Civikos është bërë për herë të parë në vitin 2022, si periudhë e monitorimit në raportin e parë është marrë periudha 2019-2021. Pra, është përfshirë monitorimi i zbatimit të të gjitha aktiviteteve prej vitit 2019 e deri në vitin 2021, duke u bazuar në Planin e Veprimit për Implementimin e Strategjisë për Periudhën 2019-2021. Ndërkaq raporti i dytë i monitorimit të zbatimit të kësaj Strategjie ka përfshirë zhvillimet e ndodhura gjatë vitit 2022. Raporti i tretë ka përfshirë zhvillimet e ndodhura përgjatë periudhës janar – qershor 2023. Raporti aktual përfshinë zhvillimet e ndodhura gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, më specifikisht nga muaji korrik deri në muajin dhjetor.

Përveç analizimit të shkallës së realizimit për secilin aktivitet brenda objektivit, metodologjia e raportit fokusohet edhe në matjen e peshës apo rëndësisë që kanë aktivitetet e parapara brenda secilës prej objektivave. Kjo metodologji është përdorur duke pasur parasysh faktin se jo të gjitha aktivitetet e kanë efektin e njëjtë, pasi disa prej tyre përfshijnë zhvillimin e legjislationit, krijimin e sistemeve apo mekanizmave të ndryshëm për zbatim të tyre, ndërsa disa prej aktiviteteve janë më shumë të natyrës teknike dhe efekti i tyre është i ndryshëm në aspektin e implementimit të objektivave. Më konkretisht, aktivitetet e planifikuara në kuadër të Objektivit Strategjik 1 janë kryesisht të natyrës teknike, ndërkohë që Objektivit Strategjik 2 përmbanë disa aktivitete të natyrës teknike dhe një pjesë tjetër që përfshinë përmirësim të kornizës ligjore dhe institucionale. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të Objektivit Strategjik 3 dhe Objektivit Strategjik 4 përfshijnë kryesisht krijimin e kornizës ligjore dhe dokumente tjera relevante.

Për realizimin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë, të dhënat fillimisht janë mbledhur përmes raporteve zyrtare dhe dokumenteve tjera mbështetëse të përgatitura nga ZQM dhe pastaj janë analizuar dhe krahasuar me të dhënat tjera, duke u bazuar në informatat e publikuara në ueb faqet e institucioneve relevante dhe në platformat ekzistuese. Të gjeturat e këtij raporti më pas janë konsultuar me anëtarët e shoqërisë civile të zgjedhur në Këshillin për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, respektivisht koordinatorët e ekipeve të punës, si dhe me qëllim të validimit të të gjeturave, raporti është konsultuar me zyrtarë nga ZQM.

Bazuar në të dhënat e mbledhura për këtë monitorim, progresi i zbatimit të aktiviteteve është kategorizuar si vijon:

- Aktivitetet plotësisht të zbatuara;
- Aktivitetet pjesërisht të zbatuara;
- Aktivitetet në proces të zbatimit;
- Aktivitetet e pazbatuara.

Si aktivitete të zbatuara plotësisht janë aktivitetet të cilat kanë arritur të zbatohen konform numrit të indikatorëve të përcaktuar me Plan të Veprimit të Strategjisë. Aktivitetet pjesërisht të zbatuara janë aktivitetet të cilat nga ana e institucioneve konsiderohen si të zbatuara plotësisht, mirëpo kur krahasohen aktivitetet e realizuara me numrin e indikatorëve të përcaktuar sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, atëherë del se këto aktivitete janë zbatuar në nivel më të ulët se numri i indikatorëve të përcaktuar. Aktivitetet në proces të zbatimit janë aktivitetet për të cilat institucionet kanë raportuar se ka filluar implementimi dhe ende është duke u punuar në finalizim të tyre. Aktivitetet e pazbatuara janë aktivitetet për zbatimin e të cilave ende nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë nga ana e institucioneve përgjegjëse.

## I. STRATEGJIA DHE ZBATIMI I SAJ

Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 është përgatitur nga Ekipi i Punës i themeluar nga Zyra e Kryeministrit, me përfaqësues të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, me mbështetje profesionale nga ZQM dhe Projekti i Asistencës Teknike i BE-së “Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile”. Ekipi i Punës (EP) për hartimin e Strategjisë është themeluar me vendimin e datës 12 korrik 2017, nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së para se të skadonte Strategjia paraprake (2013-2017). Me qëllim të sigurimit të kontributit sa më të gjerë nga OSHC-të dhe palët e tjera, janë zhvilluar takime konsultative në 5 rajone - Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Gjilan, në tetor dhe nëntor 2018. Paralelisht, Strategjia dhe teksti i Planit të Veprimit janë vënë në dispozicion për konsultim për të gjithë qytetarët e interesuar në Platformën Online për konsultime publike<sup>5</sup> duke filluar nga data 4 tetor deri me 9 nëntor (34 ditë). Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, Ekipi i Punës është takuar dhe i ka analizuar e diskutuar të gjitha kontributet e pranuar nga procesi i konsultimit për ta finalizuar draftin e fundit që është përcjellë për miratim në Qeveri.<sup>6</sup>

### Zbatimi i përgjithshëm i Strategjisë

Gjatë periudhës korrik - dhjetor 2023 janë ndërmarrë disa aktivitete nga ana e institucioneve përgjegjëse, të cilat kanë ndikuar në masë të vogël në nivelin e progresit të zbatimit të objektivave të Strategjisë. Niveli i përgjithshëm i zbatueshmërisë së objektivave të Strategjisë mbetet përafërsisht i njëjtë me atë të periudhës paraprake të raportimit, ku përveç Objektivit 4 i cili nuk karakterizohet me asnjë aktivitet të zbatuar plotësisht, tri objektivat tjera karakterizohen me aktivitete të zbatuara plotësisht. Dy objektivat e para karakterizohen me zbatim më të lartë të aktiviteteve të parapara, ndërsa nivel më i ulët i zbatimit të aktiviteteve vërehet në dy objektivat tjera.



Infografika 3: Zbatimi i përgjithshëm i Strategjisë

5 Platforma Online për Konsultime Publike. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. Linku në gjuhën shqipe: [konsultime.rks-gov.net](https://konsultime.rks-gov.net)

6 Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. 2019. Zyra për Qeverisje të Mirë. Linku për tri gjuhët: <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Strategjia%20ne%20tri%20gjuhe.pdf>

## I.1. Zbatimi i Objektivit Strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje

Gjatë hartimit të Strategjisë, si problem kryesor i identifikuar në fushën e politikë-bërjes ishte mungesa e pjesëmarrjes adekuate të OSHC-ve në formulimin e politikave dhe legjislacionit. Si rezultat, është definuar objektivi strategjik që synon rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje. Ky Objektiv Strategjik përmbanë 3 objektiva specifike me 13 aktivitete. Bazuar në të dhënat në dispozicion, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, përveç aktiviteteve të cilat janë zhvilluar si vazhdimësi nga periudhat e kaluara, nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë e re nga ana e institucioneve, e cila do të ndikonte në nivelin e progresit të aktiviteteve që parashihen në kuadër të këtij objekti. Deri në dhjetor 2023, nga gjithsej **13 aktivitetet e planifikuara, 8 aktivitete janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces të zbatimit** ndërsa **2 nuk janë zbatuar fare**. Më konkretisht, **mbi 61 përqind e aktiviteteve janë zbatuar plotësisht, mbi 7 përqind janë zbatuar pjesërisht, mbi 15 përqind janë në proces të zbatimit**, ndërsa **mbi 15 përqind nuk janë zbatuar**. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë kryesisht të natyrës teknike si: trajnime, sesione informuese, takime koordinuese etj. Prandaj edhe rëndësia e tyre në procesin e bashkëpunimit Shoqëri Civile-Qeveri konsiderohet si më e vogël në krahasim me aktivitetet që përfshijnë krijim të kornizës ligjore dhe mekanizmave zbatues.

**Objekti i parë specifik** parashihet përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultimet publike.

Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë:

- 1.1.1. *Ofrimi i njohurive mbi Rregulloren për standardet minimale për konsultime me publikun;*
- 1.1.2. *Vendosja e rregullave dhe standardeve për konsultimet me publikun në nivel lokal;*
- 1.1.3. *Ofrimi i një Programi trajnues për institucionet Qeveritare qendrore dhe lokale për metodat e përfshirjes së OSHC-ve në hartimin e politikave;*
- 1.1.4. *Avancimi dhe rritja e përdorimit të Platformës Online për konsultime me publikun;*
- 1.1.5. *Ofrimi i trajnimeve në vendin e punës për ministritë e përzgjedhura në përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike;*
- 1.1.6. *Organizimi i sesioneve informuese praktike për shfrytëzimin efektiv të Platformës Online;*
- 1.1.7. *Organizimi i takimeve koordinuese për ministritë dhe zyrat e kryeministrit;*
- 1.1.8. *Publikimi i raporteve vjetore të monitorimit mbi zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun në nivel qendror dhe lokal;*
- 1.1.9. *Publikimi i praktikave më të mira të konsultimit me institucionet shtetërore dhe komunat;*
- 1.1.10. *Rekrutimi i një zyrtari për koordinimin e procesit të konsultimeve me publikun.*

Aktivitetet e përcaktuara në Strategji në kuadër të këtij objekti ndërlidhen kryesisht me trajnime dhe sesione informuese për zbatimin e Rregullores për Standardet Minimale për Konsultime me Publikun si dhe Platformës Online për Konsultim Publik.

Në kuadër të këtij objekti specifik, përgjatë periudhës 2019-2021 është realizuar programi i trajnimit të trajnerëve për konsultim publik dhe janë realizuar shumica e trajnimeve dhe sesioneve informuese, të planifikuara për shërbyes civil nga niveli qendror e lokal për konsultimin publik dhe platformën online. Trajnime janë realizuar edhe gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, ku në muajin



shtator, ZQM bashkë me MAPL ka realizuar trajnimin “Konsultimi publik në komuna dhe procesi i publikimit në platformën për konsultime publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës”.

Platforma Online për Konsultimin Publik është avancuar përmes shtimit të modaliteteve të reja si dhe është zhvilluar fushata për ngritjen e vetëdijes për standardet e konsultimit me publikun përmes realizimit dhe shpërndarjes së videospoteve dhe fletushkave të përgatitura. Gjatë vitit 2022, Platforma është avancuar tutje duke lehtësuar qasjen në dokumentet në konsultim publik për personat me nevoja të veçanta. Më konkretisht, ka filluar publikimi i videove të cilat përmbajnë përmbledhjen e dokumenteve për personat e shurdhër, me vështirësi në të dëgjuar dhe personat e verbër. Gjithsesi, ky është aktivitet shtesë i realizuar pasi nuk ka qenë specifikisht i planifikuar në kuadër të aktivitetit që përfshinë avancimin e platformës. Në kuadër të avancimit të Platformës, nga periudha janar-qershor 2023, ZQM është duke punuar në krijimin e aplikacionit mobil të platformës, që nuk ka qenë specifikisht e planifikuar në kuadër të aktivitetit që përfshinë avancimin e platformës.

Gjatë periudhës 2019-2021 është lansuar Korniza për Përmirësimin e Zbatimit të Standardeve Minimale për Konsultimet Publike 2021-2025.

Në kuadër të aktivitetit të parë të këtij objekti specifik, sipas Planit të Veprimit ishte paraparë që të publikohej raporti i trajnimeve të mbajtura për ofrimin e njohurive mbi Platformën Online për konsultime me publikun. Në raportin e monitorimit për periudhën 2019-2021, Platforma Civike kishte evidentuar se raporti për trajnimet për vitin 2020 nuk ishte publikuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Si rezultat, gjatë vitit 2022 IKAP ka publikuar raportin për trajnimet për vitin 2020.

ZQM ka përgatitur dhe publikuar raportet vjetore të monitorimit mbi zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun në nivel qendror dhe lokal për vitet: 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Ndërkaq, raporti për vitin 2023 përgatitet dhe publikohet në pjesën e parë të vitit 2024. Raporti përfshinë të dhënat për numrin e dokumenteve të publikuara në Platformën Online për Konsultime Publike, të dhënat lidhur me plotësimin e standardeve minimale të konsultimit publik nga këto dokumente, numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve dhe të komenteve të pranuar në procesin e konsultimeve publike, numrin e komenteve të pranuar/refuzuara nga ana e institucioneve përgjegjëse dhe detaje tjera relevante për vitet respektive. Rëndësia e këtij aktiviteti qëndron në faktin se siguron transparencë në procesin e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Sipas të dhënave, gjatë periudhës 2019-2021, MAPL në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile ka themeluar ‘Forum Konsultativ për Qeverisje Lokale’ me qëllim të involvimit të tyre në politikat publike. Gjatë takimeve me Organizatat e Shoqërisë Civile janë diskutuar edhe temat rreth praktikave më të mira të konsultimit publik në nivel qendror dhe lokal. Gjithsesi, nuk ka të dhëna nëse praktikat më të mira janë publikuar.

Sa i përket rekrutimit të zyrtarit për konsultime publike, për periudhën janar-qershor 2023 është raportuar se kanë filluar të mbahen takimet në mes të ZQM dhe Zyrës së Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit rreth rregulloreve për riorganizim të brendshëm të Qeverisë, me qëllim që të përfshihet rekrutimi i një zyrtari për koordinim të procesit të konsultimeve publike. Gjithsesi, nuk ka të dhëna nëse është marrë ndonjë vendim deri në dhjetor 2023.

Rrjedhimisht, rekrutimi i zyrtarit për koordinimin e procesit të konsultimeve me publikun dhe publikimi i praktikave më të mira të konsultimit publik me institucionet qendrore dhe komunat janë aktivitetet të cilat evidentohen si ngecje edhe në këtë periudhë të raportimit.

**Objektivi i dytë specifik** parasheh ngritjen e njohurive të qytetarëve dhe Shoqërisë Civile për konsultimet publike. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë:

**1.2.1.** *Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie të komunikimit me publikun për Platformën Online dhe standardet për konsultimet me publikun;*

### *1.2.2. Zhvillimi i një fushate për ngritjen e vetëdijes për standardet e konsultimit me publikun.*

Sipas të dhënave, gjatë periudhës 2019-2021, me mbështetje të donatorëve, është përgatitur një Strategji e komunikimit me publikun mbi Platformën Online dhe standardet e konsultimeve publike, dokument i cili është ndarë edhe me anëtarët e Këshillit, mirëpo nuk është publikuar ende.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë realizuar aktivitetet për zhvillimin e fushatës për ngritjen e vetëdijes për standardet e konsultimit me publikun. Më konkretisht, janë përgatitur dhe publikuar/shpërndarë udhëzues, videospote dhe fletushka.

**Objektivi i tretë specifik** parashihet përmirësimin e kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike. Aktiviteti i planifikuar në kuadër të këtij objektivi është:

### *1.3.1. Mbajtja e sesioneve informuese për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike.*

Nuk ka të dhëna nëse deri në dhjetor 2023, institucionet përgjegjëse kanë organizuar sesionet informuese nëpër komunat e Kosovës. Ndërkohë, KCSF, nëpërmjet Qendrës së Burimeve për Shoqëri Civile, ka ofruar trajnime dhe sesione informuese për Shoqërinë Civile lidhur me shfrytëzimin e mekanizmave formal për pjesëmarrje qytetare.

Aktiviteti i paraparë në kuadër të këtij objektivi vazhdon të karakterizohet me ngecje pasi ende nuk janë realizuar sesionet nga ana e institucioneve përgjegjëse. Sesionet informuese do të rezultojnë në përgatitje më të madhe të organizatave që e përcjellin procesin e konsultimeve publike e rrjedhimisht përmirësim të këtij procesi.

Çfarë vlen të theksohet është se organizata jo-Qeveritare Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar në Kosovë punon aktivisht për të përmirësuar dhe forcuar Qeverisjen lokale në Kosovë. Më saktësisht, ata kanë përpiluar Metodologjinë e Monitorimit të Konsultimit Publik në Komuna e cila iu shërben individëve dhe organizatave të monitorojnë dhe raportojnë për gjithëpërfshirje dhe transparencën e vendimmarrjes në nivelin lokal. Metodologjia ka pikënisje Udhëzimin Administrativ 06/2008 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe Doracakun për Konsultime Publike në Komuna dhe përshkruan dhe zbërthen procesin që duhet të zbatohet në nivelin lokal. Për më shumë, KLGJ ka trajnuar 20 trajnere dhe trajnerë të cilët janë të gatshëm të angazhohen në përmirësimin e kapaciteteve të OJQ-ve për të monitoruar dhe marr pjesë në politikë-bërje në nivelin lokal. Në fund të vitit 2023 janë përzgjedhur organizatat dhe aktivistët që do të angazhohen në monitorim. Së paku 28 komuna nga 8 rajone do të përfshihen në monitorim.



## Objektiva 1

### RRITJA E PJESËMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKË-BËRJE



#### Aktivitetet e zbatuara plotësisht

- 1.1.1. Ofrimi i njohurive mbi Rregulloren për standardet minimale për konsultime me publikun;
- 1.1.2. Vendosja e rregullave dhe standardeve për konsultimet me publikun në nivel lokal;
- 1.1.3. Ofrimi i një Programi trajnues për institucionet qeveritare qendrore dhe lokale për metodat e përfshirjes së OShC-ve në hartimin e politikave;
- 1.1.4. Avancimi dhe rritja e përdorimit të Platformës Online për konsultime me publikun;
- 1.1.6. Organizimi i sesioneve trajnuese praktike për shfrytëzimin efektiv të Platformës Online;
- 1.1.7. Organizimi i takimeve koordinuese për ministrinë dhe zyrat e kryeministrit;
- 1.1.8. Publikimi i raporteve vjetore të monitorimit mbi zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun në nivel qendror dhe lokal;
- 1.2.2. Zhvillimi i një fushate për ngritjen e vetëdijes për standardet e konsultimit me publikun.



#### Aktivitetet e zbatuara pjesërisht

- 1.1.5. Ofrimi i trajnimeve në vendin e punës për ministrinë e përzgjedhura në përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike.



#### Aktivitetet në proces të zbatimit

- 1.1.9. Publikimi i praktikave më të mira të konsultimit me institucionet shtetërore dhe komunat;
- 1.2.1. Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie të komunikimit me publikun për Platformën Online dhe standardet për konsultimet me publikun.



#### Aktivitetet e pazbatuara

- 1.1.10. Rekrutimi i një zyrtari për koordinimin e procesit të konsultimeve me publikun;
- 1.3.1. Mbajtja e sesioneve informuese për rritjen e kapaciteteve të OShC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publik.

Infografika 4: Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit 1

## I.2. Zbatimi i Objektivit Strategjik 2: Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik

Si problem kryesor i identifikuar në fushën e financimit publik ishte jo-operacionalimi i financimit direkt dhe indirekt të OShC-ve. Si rezultat, është definuar objektivi strategjik që synon përmirësimin e kornizës institucionale dhe ligjore për financimin publik të OShC-ve. Ky Objektiv Strategjik përmbanë 4 objektiva specifike me 20 aktivitete. Bazuar në të dhënat në dispozicion, edhe sa i përket këtij objektivi, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, përveç aktiviteteve të cilat janë zhvilluar si vazhdimësi nga periudhat e kaluara, nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë e re nga ana e institucioneve, e cila do të ndikonte në nivelin e progresit të aktiviteteve që parashihen në kuadër të këtij objektivi. Deri në dhjetor 2023, nga gjithsej **20 aktivitetet e planifikuara, 8 aktivitete janë zbatuar plotësisht, 1 aktivitet është zbatuar pjesërisht, 2 aktivitete janë në proces të zbatimit** ndërsa **9 nuk janë zbatuar fare**. Më konkretisht, **40 përqind e aktiviteteve janë zbatuar plotësisht, 5 përqind janë zbatuar pjesërisht, 10 përqind janë në proces të zbatimit** ndërsa **45 përqind prej tyre nuk janë zbatuar**. Nëse analizohet për nga pesha e rëndësisë që ka moszbatimi i aktiviteteve të lartcekura, atëherë mund të kuptohet se edhe përkundër që janë bërë përmirësime të dukshme

në financimin publik të OSHC-ve, janë dy fusha të rëndësishme brenda këtij objekti në të cilat nuk është shënuar progres. Pra, kemi të bëjmë me krijim të kornizës ligjore dhe mekanizma të zbatimit, që krahasuar me aktivitetet që janë më shumë të natyrës teknike si: trajnime, sesione informuese, takime etj., kanë peshë më të madhe në aspektin e bashkëpunimit Shoqëri Civile-Qeveri.

**Objekti i parë specifik** parasheh fuqizimin e kapaciteteve të ministrive dhe komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OSHC-ve. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë:

- 2.1.1. *Zhvillimi i programit trajnues për ministritë dhe komunat për zbatimin e Rregullores dhe për vlerësimin e propozimeve të projekteve dhe programeve të OSHC-ve për ministritë dhe komunat;*
- 2.1.2. *Ofrimi i trajnimeve në vend të punës dhe mentorimi (duke përfshirë edhe rolin mbikëqyrës) për ministritë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve dhe programeve të OSHC-ve;*
- 2.1.3. *Organizimi i takimeve bashkërenduese për ZKM, ministritë dhe komunat për planifikimin e përbashkët dhe raportimin për financimin publik të OSHC-ve;*
- 2.1.4. *Publikimi i raporteve vjetore për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë;*
- 2.1.5. *Përmirësimi i bazës qendrore të të dhënave për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë;*
- 2.1.6. *Rishikimi i Manualit për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OSHC-ve;*
- 2.1.7. *Rritja e rolit mbikëqyrës të MF-së në zbatimin e Rregullores;*
- 2.1.8. *Krijimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet OB dhe OSHC-ve lidhur me ciklin e financimit të OSHC-ve për financat publike (planifikimi, ekzekutimi dhe auditimi).*

Në aspektin e organizimit të trajnimeve, sipas të dhënave, gjatë periudhës 2019-2021 është ofruar programi i trajnimit të trajnerëve për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe pjesa më e madhe e sesioneve informuese dhe trajnimeve tjera të planifikuara janë realizuar.

Një prej të arriturave kryesore në kuadër të aktiviteteve të këtij objekti është lansimi i Platformës Qendrore për Financimin Publik të OSHC-ve, përmes së cilës është krijuar një sistem i cili siguron transparencë në këtë fushë. Kjo platformë është përmirësuar gjatë periudhës 2019-2021 dhe tash mund të gjenden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OSHC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, etj. Po ashtu, sipas të dhënave, gjatë vitit 2022 janë bërë disa ndryshime në Platformën Qendrore për Financimin Publik të OJQ-ve, duke mundësuar raportimin për financimin publik të OJQ-ve direkt në Platformë si dhe publikimin e të dhënave për fondet e donatorëve ndërkombëtarë për OJQ-të. Në të kaluarën, Zyra për Qeverisje të Mirë, mbledhjen e të dhënave për fondet publike e ka bërë duke iu drejtuar me kërkesë organizatave buxhetore që të përgatisin raportet mbi financimin publik të OSHC-ve si dhe ka përdorur bazën e të dhënave të ofruara nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave, si institucion që e bën menaxhimin e ekzekutimit të mjeteve nga organizatat buxhetore. Megjithatë, ngecje në këtë drejtim konsiderohet specifikimi i mjeteve që janë dhënë për OJQ-të, duke e bërë dallimin ndërmjet mjeteve që janë dhënë për grante dhe atyre që janë dhënë për subvencione. Kjo pasi një pjesë e tyre jepen si grante për OSHC-të ndërkohë që një pjesë tjetër e mjeteve jepen për kontraktim të shërbimeve nga OSHC-të, pra jepen për shërbime (sociale, familjare, kujdes shëndetësor etj.) për të cilat, institucionet janë përgjegjëse për t'i ofruar, por që në mungesë të kapaciteteve, e bëjnë kontraktimin e OSHC-ve për të ofruar këto shërbime. Po ashtu, ekzistojnë entitete të shumta si p.sh klubet sportive të cilat kontraktohen nga institucionet, për ofrimin e shërbimeve të caktuara. Publikimi i të dhënave në të

njëtin vend po e krijojnë përshtypjen se të gjitha mjetet janë dhënë në formë të granteve për OSHC-të. Specifikim më i qartë duhet të bëhet edhe në paraqitjen e të dhënave për burimin e financimit të OJQ-ve.

Me qëllim të rritjes së rolit mbikqyrës të Ministrisë së Financave në zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OSHC-ve, ishte paraparë që MF të dërgojë një letër qarkore për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve. Mirëpo, edhe pse sipas të dhënave nga ZQM se Departamenti i Buxhetit gjatë komunikimit me organizata buxhetore vazhdimisht kërkon të zbatohet Rregullorja, për periudhën 2019-2021 nuk kishte informacion nëse një dokument i tillë është përgatitur dhe dërguar nga Ministria tek institucionet. Si rezultat, Platforma Civikos, në raportin e monitorimit për 2019-2021 e pati evidentuar si aktivitet pjesërisht të zbatuar. Pas ngritjes së kësaj çështjeje në mbledhjen e rregullt të Këshillit, nga ana e koordinatorit të Ekipit 2 të Këshillit (duke u bazuar në raportin e kaluar të monitorimit të zbatimit të Strategjisë nga Civikos) Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në dhjetor të vitit 2022 ka përgatitur një qarkore të cilën fillimisht e ka ndarë për komente me OSHC-të dhe më pas e ka dërguar tek institucionet. Rrjedhimisht, tani ky aktivitet konsiderohet si plotësisht i zbatuar. Nëpërmjet kësaj qarkoreje jepen udhëzime të qarta për institucionet për zbatim të Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve, dhe si e tillë qarkorja ndikon në zbatim më të madh dhe më të drejtë të kriterëve të Rregullores. Rrjedhimisht, sigurohet transparencë më e madhe në procesin e financimit publik të OJQ-ve. Zbatimi i këtij aktiviteti paraqet një ndër të arriturat kryesore që e karakterizon zbatimin e Strategjisë për vitin 2022.

ZQM ka përgatitur dhe publikuar raportet vjetore për financimin publik të OSHC-ve për vitet: 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Raporti për vitin 2023 përgatitet dhe publikohet në pjesën e parë të vitit 2024. Raporti përmbanë të dhëna të detajuara mbi fondet publike të dhëna nga institucionet qendrore dhe lokale për Organizatat Jo-Qeveritare nga Qeveria, Ministrinë dhe Komunitetet për përkrahje në fusha të ndryshme të cilat janë të ndërlidhura me prioritetet e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe shoqërisë kosovare. Gjithashtu, organizata jo-Qeveritare Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar ka realizuar monitorimin e financimit publik të OSHC-ve për vitin 2022, raport ky i publikuar në nëntor të vitit 2023. Në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm do të fillojë procesi i monitorimit për vitin 2023.

Ngecje në implementimin e këtij objekti mbetet organizimi i të gjitha trajnimeve në vend të punës dhe mentorimit për institucionet për përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve të OSHC-ve. Po ashtu, ngecje mbetet rishikimi i Manualit për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OSHC-ve. Në lidhje me këtë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka raportuar që rregullorja aktuale e financimit publik të OJQ-ve do të ndryshohet dhe kjo do të realizohet pas aprovimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike. Rrjedhimisht, meqë përmes manualit synohet të jepen udhëzime për zbatim të kriterëve dhe procedurave të rregullores, rishikimi i tij mbetet të bëhet pasi të ndodhin këto ndryshime, pra pasi të ndryshohet edhe Rregullorja për Financimin Publik të OJQ-ve.

**Objekti i dytë specifik** parasheh krijimin e kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë:

- 2.2.1. *Rishikimi i kornizës ligjore e përkufizimit dhe rregullimit të filantropisë (duke përfshirë dhurimet, harmonizimin e fushave të OBP-së);*
- 2.2.2. *Dizajnimi dhe zhvillimi i programit/sistemit trajnues për zyrtarët e tatimit për praktikën vendore dhe ndërkombëtare të administrimit të përfitimeve tatimore për filantropinë individuale dhe të korporatave;*
- 2.2.3. *Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave;*

#### *2.2.4. Fushatat informuese për biznese dhe qytetarë për mundësinë që individët ose korporatat ofrojnë për filantropinë.*

Në prill të vitit 2022 është mbajtur takimi i parë i Forumit joformal të Filantropisë, duke shënuar kështu themelimin e Forumit në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, një përpjekje e përbashkët e KCSF dhe misionit të USAID në Kosovë për të ofruar një platformë që mundëson diskutimin sistematik të çështjeve dhe veprimeve për të sjellë një ekosistem më të favorshëm ligjor dhe praktik për filantropinë në Kosovë. Një analizë e kornizës ligjore dhe rregullative për filantropinë në Kosovë është duke u zhvilluar nga KCSF në bashkëpunim me European Center for not-for-Profit Law, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar. Gjetjet dhe rekomandimet do të diskutohen me akterët relevant. Analiza ka qasje gjithëpërfshirëse dhe shumë-shtresore të pengesave kryesore që pengojnë zhvillimin e filantropisë, ofron praktika krahasuese evropiane dhe propozon zgjidhje specifike për çështjet e identifikuar. Analiza do të shërbejë si bazë për të nisur dialog politikash që promovon kulturë të dhurimeve individuale për kauza të së mirës publike.

Ndonëse sipas Planit të Veprimit të Strategjisë ishte paraparë të rishikohej korniza ligjore dhe të krijeshin mekanizmat institucional për zhvillimin e filantropisë, aktivitete të tilla nuk janë ndërmarrë as deri në dhjetor të vitit 2023. Rrjedhimisht, këto aktivitete karakterizohen me ngecje dhe moszbatimi i tyre e lë fushën e filantropisë të parregulluar. Kjo rezulton në stabilitet të ulët në aspektin financiar të OSHC-ve.

**Objektivi i tretë specifik** parasheh rregullimin e ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë:

- 2.3.1. Krijimi i standardeve, procedurave, kriterëve dhe mekanizmave institucional transparent për rregullimin e dhënies së pronave shtetërore në shërbim të OSHC-ve;*
- 2.3.2. Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/sistemi trajnues për shërbyesit civil mbi përdorimin e standardeve dhe procedurave për rregullimin e dhënies së pronës publike në shfrytëzim të OSHC-ve;*
- 2.3.3. Zhvillimi i Regjistrit Elektronik të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim të OSHC-ve.*

Sipas të dhënave në dispozicion, në vitin 2020 është miratuar Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Rregullorja për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të cilat rregullojnë procedurat, kriteret si dhe mekanizmat transparentë për rregullimin e alokimit të pronës komunale për përdorim nga OSHC-të. Gjatë vitit 2022 MAPL ka filluar procesin e plotësim/ndryshimit të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, mirëpo ky është një aktivitet shtesë krahas aktiviteteve të realizuara. Projektligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës është miratuar nga ana e Qeverisë në muajin dhjetor të vitit 2023.

Sa i përket aktivitetit që mbulon krijimin e një regjistri elektronik të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim të OSHC-ve, edhe pse sipas raportimit nga ZQM, komunat në bazë të Ligjit dhe Rregullores përkatëse për këtë fushë janë të obliguara ta publikojnë listën e pronave komunale që jepen në shfrytëzim, deri në vitin 2023 nuk ishte ndërmarrë iniciativë për krijimin e regjistrit. Civikos, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë ka luajtur rol të rëndësishëm në këtë proces, ku përmes takimeve dhe komunikimit me MAPL ka avokuar që ky regjistër të fillojë të zhvillohet. Si rezultat, në pjesën e parë të vitit 2023 është marrë konfirmimi nga MAPL se Regjistri elektronik i pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim për OSHC-të do të përfshihet në platformën e-Komuna. Krijimi i regjistrit tashmë është përfshirë si pjesë e procesit të avancimit të kësaj platforme, proces ky për të cilin ende janë duke u zhvilluar procedurat përkatëse nga ana e MAPL-së. Ky regjistër është i rëndësishëm sepse përmes tij synohet

që të përmbledhen në një vend të veçantë të dhënat për pronat që secila komunë jep në shfrytëzim për OSHC-të. Në këtë mënyrë sigurohet informim i drejtë dhe i qartë i palëve të interesit nëpërmjet një qasjeje të lehtësuar në këto të dhëna.

**Objektivi i katërt specifik** parasheh krijimin e sistemit të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të financuara nga Bashkimi Evropian. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë:

- 2.4.1. *Krijimi i mekanizmit financues në Ministrinë e Integritetit për Bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE për OSHC-të;*
- 2.4.2. *Krijimi i mekanizmit financues në Ministrinë e Integritetit për Bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE për OSHC-të;*
- 2.4.3. *Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/sistemi trajnues për shërbyesit civil dhe OSHC-të për përdorimin e standardeve dhe procedurave për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja;*
- 2.4.4. *Mbajtja e sesioneve informuese për OSHC-të për mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve të mbështetura nga BE-ja;*
- 2.4.5. *Mbajtja e sesioneve informuese për OSHC-të për mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve të mbështetura nga BE-ja.*

Ndonëse sipas Planit të Veprimit të Strategjisë ishte paraparë krijimi i mekanizmit financues, vendosja e standardeve, procedurave dhe mekanizmave institucional për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja dhe aktivitete tjera që ndërlidhen me rregullimin e kësaj fushe, asnjëra nga këto aktivitete nuk janë ndërmarrë nga ana e institucioneve. Rrjedhimisht, këto aktivitete janë evidentuar si ngecje.

## Objektiva 2

### PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR FINANCIM NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË OShC-VE ME INTERES PUBLIK



#### Aktivitetet e zbatuara plotësisht

- 2.1.1. Zhvillimi i programit trajnues për ministrinë dhe komunat për zbatimin e Rregullores dhe për vlerësimin e propozimeve të projekteve dhe programeve të OShC-ve për ministrinë dhe komunat;
- 2.1.3. Organizimi i takimeve bashkënduese për ZKM, ministrinë dhe komunat për planifikimin e përbashkët dhe raportimin për financimin publik të OShC-ve;
- 2.1.4. Publikimi i raporteve vjetore për financimin publik të OShC-ve në Kosovë;
- 2.1.5. Përmirësimi i bazës qendrore të të dhënave për financimin publik të OShC-ve në Kosovë. [ojqfinancime.rks-gov.net](http://ojqfinancime.rks-gov.net);
- 2.1.7. Rritja e rolit mbikëqyrës të MF-së në zbatimin e Rregullores;
- 2.3.1. Krijimi i standardeve, procedurave, kriterëve dhe mekanizmave institucional transparent për rregullimin e dhënies së pronave shtetëror në shërbim të OShC-ve;
- 2.3.2. Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/ sistemi trajnues për shërbyesit civil mbi përdorimin e standardeve dhe procedurave për rregullimin e dhënies së pronës publike në shfrytëzimin të OShC-ve;
- 2.4.5. Rekrutimi i zyrtarit të ri për koordinimin e procesit të financimit publik të OShC-ve.



#### Aktivitetet e zbatuara pjesërisht

- 2.1.2. Ofrimi i trajnimeve në vend të punës dhe mentorimi (duke përfshirë edhe rolin mbikëqyrës) për ministrinë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve dhe programeve të OShC-ve.



#### Aktivitetet në proces të zbatimit

- 2.1.8. Krijimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet OB dhe OShC-ve lidhur me ciklin e financimit të OShC-ve për financat publike (planifikimi, ekzekutimi dhe auditimi);
- 2.3.3. Zhvillimi i Regjistrisë Elektronike të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzimin të OShC-ve;



#### Aktivitetet e pazbatuara

- 2.1.6. Rishikimi i Manualit për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OShC-ve;
- 2.2.1. Të rishikohet korniza ligjore e përkufizimit dhe rregullimit të filantropisë (duke përfshirë dhurimet, harmonizimin e fushave të OBP-së);
- 2.2.2. Dizajnimi dhe zhvillimi i programit/sistemit trajnues për zyrtarët e tatimit për praktikën vendore dhe ndërkombëtare të administrimit të përfitimeve tatimore për filantropinë individuale dhe të korporatave;
- 2.2.3. Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave;
- 2.2.4. Fushatat informuese për biznese dhe qytetarë për mundësinë që individët ose korporatat ofrojnë për filantropinë;
- 2.4.1. Krijimi i mekanizmit financues në Ministrinë e Integritetit për Bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE për OShC-të;
- 2.4.2. Vendosja e standardeve, procedurave dhe mekanizmave institucional për bashkëfinancimin e projekteve të OShC-ve të mbështetura nga BE-ja;
- 2.4.3. Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/ sistemi trajnues për shërbyesit civil dhe OShC-të për përdorimin e standardeve dhe procedurave për bashkëfinancimin e projekteve të OShC-ve të mbështetura nga BE-ja;
- 2.4.4. Mbajtja e sesione informuese për OShC-të për mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve të mbështetura nga BE-ja.

Infografika 5: Zbatimi i i aktiviteteve në kuadër të Objektivit 2



### I.3. Zbatimi i Objektivit Strategjik 3: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve publike

Problemi kryesor i identifikuar në fushën e ofrimit të shërbimeve ka të bëjë me praktikën e pazhvilluar dhe jo transparente për kontraktimin e OSHC-ve për të ofruar shërbime publike. Si rezultat, është definuar objektivi që synon zhvillimin e praktikave dhe procedurave për kontraktim të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve. Ky Objektiv Strategjik përmban 4 objektiva specifike me 9 aktivitete. Bazuar në të dhënat në dispozicion, përgjatë periudhës korrik-dhjetor 2023 është ndërmarrë iniciativa për zbatimin e aktivitetit i cili parasheh krijimin e standardeve, procedurave dhe kriterëve për rregullimin e kontraktimit të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve. Kjo ka ndikuar në nivelin e progresit të zbatimit të aktiviteteve të parapara në kuadër të këtij objektivi, ku aktiviteti i lartpërmendur tani karakterizohet si aktivitet në proces të zbatimit. Rrjedhimisht, deri në dhjetor 2023, nga gjithsej **9 aktivitete të planifikuara, 1 aktivitet është zbatuar plotësisht, 3 aktivitete janë në proces të zbatimit**, ndërsa **5 të tjera nuk janë zbatuar fare**. Më konkretisht, mbi **33 përqind e aktiviteteve janë në proces të zbatimit, mbi 11 përqind plotësisht të zbatuara**, ndërsa mbi **55 përqind nuk janë zbatuar**. Nëse analizohet për nga pesha e rëndësisë që ka zbatimi apo moszbatimi i aktiviteteve, atëherë mund të kuptohet se me fillimin e punës në hartimin e legjislacionit sekondar për kontraktim të shërbimeve, është shënuar progres mjaft i madh në këtë fushë pasi kemi të bëjmë me krijim të kornizës ligjore, që krahasuar me aktivitetet që janë më shumë të natyrës teknike si: trajnime, sesione informuese, takime etj., ka peshë më të madhe në aspektin e bashkëpunimit Shoqëri Civile-Qeveri. Në anën tjetër, një fushë që nuk karakterizohet me progres deri në këtë periudhë të monitorimit, e që po ashtu ka të bëjë me krijim të kornizës ligjore dhe mekanizmave të zbatimit, ndërlidhet me pjesën e rregullimit të aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve.

**Objektivi i parë specifik** parasheh përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi janë:

- 3.1.1. *Konsolidimi i kornizës së përgjithshme ligjore, duke përfshirë legjislacionin tatimor, në lidhje me aktivitetet ekonomike të OSHC-ve;*
- 3.1.2. *Përgatitja e Udhëzimeve për zbatimin e kornizës së konsoliduar ligjore me raste studimore;*
- 3.1.3. *Organizimi i sesioneve informuese për shërbyesit civil, duke përfshirë zyrtarët tatimor, për t'i informuar ata për ndryshimet në kornizën ligjore.*

Aktivitetet tjera të parapara në kuadër të këtij objektivi nuk janë realizuar ende. Sa i përket aktivitetit që përfshin konsolidimin e kornizës ligjore, duke përfshirë legjislacionin tatimor, në lidhje me aktivitetet ekonomike, gjatë periudhës janar-qershor 2023, nga ana e MFPT-së është raportuar se legjislacioni tatimor është në proces të ndryshimit. Mirëpo, nuk ka të dhëna nëse ndryshimet ndërlidhen direkt me aktivitetet ekonomike të OSHC-ve. Ndonëse ndryshimi i legjislacionit tatimor ishte pjesë e programit legjislativ për vitin 2023, nuk ka zhvillime konkrete dhe informata specifike lidhur me procesin, nëse është përfunduar brenda vitit 2023. Përmes implementimit të këtyre aktiviteteve do të krijohet qartësi më e madhe në atë se si mund t'i zhvillojnë OSHC-të aktivitetet ekonomike në mënyrë që përmes tyre të krijojnë stabilitet financiar dhe të mos mbeten në varësi të fondeve nga institucionet apo donatorët tjerë.

**Objektivi i dytë specifik** parasheh rregullimin e standardeve dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi janë:

- 3.2.1. *Finalizimi i vlerësimit të nevojave për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të në fusha të ndryshme të punës;*
- 3.2.2. *Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi trajnues për shërbyesit civil për të mësuar rreth kornizës ligjore dhe modelet ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve në lidhje me*

*ofrimin e shërbimeve publike;*

### **3.2.3. Lansimi i fushatës për informim publik për OSHC-të rreth mundësive për të ndihmuar Qeverinë të ofrojë shërbime publike.**

Finalizimi i vlerësimit të nevojave për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të në fusha të ndryshme të punës është aktiviteti i vetëm i cili është realizuar plotësisht në kuadër të Objektivit Strategjik 3. Platforma Civikos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë në vitin 2022 ka përgatitur vlerësimin e nevojave të organizatave që ofrojnë shërbime në kuadër të projektit “Mitigating the impact of the COVID-19 pandemic on CSOs providing services” mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, financuar nga German Marshall Fund -USAID. Më konkretisht, janë përgatitur dokumentet “Hartëzimi dhe Sfidat e Organizatave të Shoqërisë Civile në Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Kosovë”; “Dokument i Politikave Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OSHC-të”; dhe “Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OJQ-të”. Dokumentet paraqesin gjendjen aktuale në fushën e kontraktimit të shërbimeve, duke identifikuar sfidat dhe nevojat e OSHC-ve që ofrojnë shërbime, pastaj informata mbi legjislacionin në fuqi në Kosovë për këtë fushë dhe rekomandime konkrete për ndërmarrjen e veprimeve ligjore për rregullimin e kontraktimit të shërbimeve me OSHC-të. Rëndësia e hartimit të tyre qëndron në faktin se kanë kontribuar drejtpërdrejt në zbatim të Objektivit Strategjik 3, respektivisht aktivitetit “Finalizimi i vlerësimit të nevojave për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të në fusha të ndryshme të punës”.

Gjithashtu, në kuadër të aktivitetit për lansimin e fushatës për informimin publik për OSHC-të rreth mundësive për të ndihmuar Qeverinë të ofrojë shërbime publike, sipas të dhënave, Zyra për Qeverisje të Mirë ka qenë pjesë e aktivitetit që CDF, ku në kuadër të Programit të financuar nga granti i Fondit Global kanë iniciuar diskutimin dhe procesin e krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të financimit publik të OSHC-ve për të ofruar shërbime shëndetësore parandaluese të bazuara në komunitet, në kuadër të Programeve kombëtare për HIV dhe TB.

Ngecjet në kuadër të këtij objekti specifik evidentohen në aktivitetet që ndërlidhen me dizajnimin dhe zhvillimin e programit trajnues në lidhje me kornizën ligjore dhe modelet ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve publike si dhe me fushatën informuese për OSHC-të rreth mundësive për të ndihmuar Qeverinë të ofrojë shërbime publike.

**Objekti i tretë specifik** parasheh mbledhjen dhe publikimin e informacioneve rreth shërbimeve që ofrojnë OSHC-të. Aktiviteti i planifikuar në kuadër të këtij objekti është:

#### **3.3.1. Mbledhja dhe publikimi sistematik i informatave mbi potencialin e OSHC-ve për të ofruar shërbime publike për institucionet publike.**

Sa i përket krijimit të databazës së OSHC-ve që ofrojnë shërbime publike, sipas të dhënave, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e posedon një listë të organizatave që ofrojnë shërbime sociale si dhe Ministria e Shëndetësisë listën e organizatave që ofrojnë shërbime shëndetësore. Megjithatë, për t’u konsideruar si aktivitet i përmbyllur, databaza do të duhej të ishte e krijuar. Deri në dhjetor 2023 nuk ka të dhëna nëse është dizajnuar dhe kompletuar databaza. Kjo databazë do të shërbente si adresë e veçantë me informata mbi organizatat që ofrojnë shërbime në Kosovë.

**Objekti i katërt specifik** parasheh përmirësimin e legjislacionit që rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objekti janë:

#### **3.4.1. Krijimi i standardeve, procedurave dhe kriterëve për rregullimin e ofrimit të shërbimeve publike nga OSHC-të;**

#### **3.4.2. Përgatitja e një Manuali Online me udhëzime për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike, në bazë të kornizës ligjore të ndryshuar.**




Në kuadër të aktivitetit që mbulon krijimin e standardeve, procedurave dhe kritereve për rregullimin e shërbimeve publike nga OSHC-të, në dhjetor të vitit 2023 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka themeluar grupin punues për hartimin e Rregullores për Kontraktim të Shërbimeve të OSHC-ve, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të OSHC-ve. Takimi i parë i grupit punues është mbajtur në muajin dhjetor. Zbatimi i këtij aktiviteti e rregullon fushën e kontraktimit të shërbimeve në përgjithësi dhe rezulton në stabilitet të Organizatave të Shoqërisë Civile që ofrojnë shërbime, duke i rritur mundësitë për qytetarët që të marrin shërbimet për të cilat kanë nevojë.

Ndërkaq, ngecja që evidentohet në kuadër të këtij objekti specifik ka të bëjë me përgatitjen e manualit online me udhëzime për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike, në bazë të kornizës ligjore të ndryshuar.

### Objektiva 3

#### ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE PËR KONTRAKTIMIN E OShC-VE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE



Infografika 6: Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit 3

#### I.4. Zbatimi i Objektivit Strategjik 4: Rritja e vullnetarizmit për programet me interes publik

Problem kryesor i identifikuar për fushën e vullnetarizmit ishte mungesa e vullnetarizmit në programet në interes të publikut. Si rezultat, është definuar objektivi strategjik që synon rritjen e vullnetarizmit për programet me interes publik. Ky Objektiv Strategjik përmbanë 3 objektiva specifike me 6 aktivitete. Bazuar në të dhënat në dispozicion, deri në dhjetor 2023, nga gjithsej **6 aktivitete të planifikuara, 3 aktivitete janë në proces të zbatimit** ndërsa **3 të tjera nuk janë zbatuar fare**. Rrjedhimisht, **50 përqind e aktiviteteve janë në proces të zbatimit** ndërsa **50 përqind e aktiviteteve nuk janë zbatuar**. Ky Objektiv Strategjik është objektivi i vetëm në kuadër të të cilit asnjë aktivitet nuk është realizuar në tërësi deri më tani.

Nëse analizohet për nga pesha e rëndësisë që ka moszbatimi i aktiviteteve atëherë mund të kuptohet se edhe gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, përveç faktit që asnjë aktivitet nuk është zbatuar në tërësi, në kuadër të këtij objektivi mbesin dy fusha në të cilat nuk është shënuar progres. Pra, edhe këtu kemi të bëjmë me krijim të kornizës ligjore dhe mekanizma të zbatimit, që krahasuar me aktivitetet që janë më shumë të natyrës teknike si: trajnime, sesione informuese, takime etj., kanë peshë më të madhe në aspektin e bashkëpunimit Shoqëri Civile-Qeveri. Më konkretisht, aktivitetet e planifikuara ndërlihen me implementimin e rekomandimeve nga koncept-dokumenti për vullnetarizmin dhe me lansimin e një skeme të granteve për financimin e aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve për OSHC-të për menaxhimin efektiv të vullnetarëve.

**Objektivi i parë specifik** parasheh krijimin e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale për të ndihmuar në zhvillimin e vullnetarizmit. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi janë:

4.1.1. *Hartimi dhe miratimi i Koncept Dokumentit mbi Vullnetarizmin;*

4.1.2. *Implementimi i rekomandimeve nga Koncept dokumenti.*

Ndër hapat më të rëndësishëm të ndërmarrë në kuadër të këtij objektivi mund të konsiderohet koncept-dokumenti për vullnetarizmin i cili synon ta rregullojë dhe promovojë këtë fushë. Sipas të dhënave, në vitin 2019 një koncept-dokument është përgatitur dhe ndarë me OSHC-të që punojnë në këtë fushë, mirëpo nuk është miratuar ende. Rrjedhimisht, aktivitetet tjera të parapara në kuadër të këtij objektivi, që do të duhej të derivonin nga ky dokument, nuk kanë arritur të zbatohen.

Gjatë vitit 2022, KCSF në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar ka filluar studimin fillestar rreth vullnetarizmit në Kosovë cili ka për qëllim të nxjerrë rekomandime dhe zgjidhje konkrete mbi përmirësimin e ekosistemit të vullnetarizmit në Kosovë. Hulumtimi është finalizuar në pjesën e dytë të vitit 2023 dhe në periudhën vijuese do të identifikohen mundësitë për promovim dhe angazhim në vullnetarizëm dhe do të diskutohen me palët relevante.

**Objektivi i dytë specifik** parasheh zhvillimin e kapaciteteve të OSHC-ve për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi janë:

4.2.1. *Lansimi i një skeme të granteve për financimin e aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve për OSHC-të për menaxhimin efektiv të vullnetarëve;*

4.2.2. *Përgatitja e një Manuali me udhëzime për rekrutimin dhe menaxhimin e vullnetarëve.*

Të dy aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi specifik evidentohen si ngecje pasi asnjëra nuk është realizuar deri më tani.

**Objektivi i katërt specifik** parasheh rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij objektivi janë:

4.3.1. Zhvillimi i një fushate për ngritjen e njohurive për vullnetarizmin dhe rolin e tij në përmirësimin e mirëqenies së publikut;


4.3.2. Përmirësimi i regjistrimit Online për vullnetarët e rinj të regjistruar.

Sipas të dhënave, ZQM ka qenë pjesë e disa aktiviteteve në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit si dhe një videospot për rëndësinë e vullnetarizmit është realizuar dhe transmetuar.

Ndonëse, sipas të dhënave dhe informatave nga organizatat që merren me aktivitete në fushën e vullnetarizmit, platforma online për vullnetarët e rinj të regjistruar është rifunksionalizuar, kjo platformë duhet të rifreskohet me të dhëna, të mirëmbahet dhe të mundësojë regjistrimin e të gjitha të dhënave të nevojshme që ndërlidhen me punën vullnetare.

#### Objektiva 4


#### RRITJA E VULLNETARIZMIT PËR PROGRAMET ME INTERES PUBLIK



Infografika 7: Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit 4

## II. PUNA E KËSHILLIT PËR BASHKËPUNIM TË QEVERISË ME SHOQËRINË CIVILE<sup>7</sup>

Këshilli për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile është themeluar në vitin 2019 dhe paraqet mekanizmin kryesor këshillues të përhershëm i cili koordinon gjithë procesin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile. Këshilli ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile, promovimin dhe mbështetjen e forcimit të sektorit të Shoqërisë Civile dhe sigurimin e koordinimit e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.



Gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, janë mbajtur dy takime të rregullta të Këshillit. Ndërsa, që nga themelimi e deri në fund të vitit 2023, janë mbajtur gjithsej 13 takime/punëtori të Këshillit, ku më së shumti takime janë mbajtur në vitin 2022 ndërsa më së paku në vitin 2021. Më specifikisht: tri takime/punëtori janë mbajtur në vitin 2019, dy në vitin 2020, një në vitin 2021, katër në vitin 2022 dhe tri në vitin 2023.

Infografika 8: Përbërja e Këshillit



Në kuadër të Këshillit funksionojnë edhe **4 ekipe të punës** të cilat janë themeluar për secilën nga objektivat strategjike të Strategjisë. Ekipet përbëhen nga anëtarët e Këshillit, ZQM dhe përfaqësues të institucioneve publike dhe OSHC-ve të tjera, fushëveprimi i të cilave përputhet me objektivat përkatëse strategjike. Secila nga këto ekipe e ka të zgjedhur edhe koordinatorin/en (koordinatorët e zgjedhur të ekipeve janë përfaqësues nga Shoqëria Civile). ZQM gjithashtu shërben si Sekretariat i Këshillit dhe është në funksion për të zhvilluar dhe mirëmbajtur të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.

Infografika 9: Numri i takimeve/punëtorive të Këshillit

<sup>7</sup> <http://www.Civikos.net/sq/anetaret-e-keshillit-2019-2023>

Që nga themelimi i Këshillit dhe ekipeve të punës e deri në fund të vitit 2023, këto ekipe janë takuar si vijon: gjatë vitit 2019 është mbajtur nga një takim për secilin prej ekipeve të punës, ndërsa në vitin 2020 janë mbajtur nga dy takime për Ekipin I dhe Ekipin II. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 Ekipi I ka mbajtur tri takime, Ekipi II ka mbajtur dy takime, ndërsa Ekipi III dhe Ekipi IV kanë mbajtur nga një takim. Gjatë vitit 2022, secili nga ekipet e punës e ka mbajtur nga një takim të rregullt ndërsa gjatë vitit 2023 Ekipi II dhe Ekipi III e kanë mbajtur nga një takim.

Përveç takimeve të rregullta të Këshillit dhe ekipeve të punës, janë mbajtur edhe takime të përbashkëta të koordinatorëve të ekipeve. Në vitin 2020 është mbajtur një takim i koordinatorëve, në vitin 2021 janë mbajtur katër të tilla, përderisa tri takime janë mbajtur gjatë vitit 2022 dhe dy gjatë vitit 2023.

Sipas Vendimit për Themelimin e Ekipeve të Punës, ndër përgjegjësitë kryesore të anëtarëve të këtyre ekipeve është të identifikojnë të arriturat dhe sfidat në zbatimin e planeve të punës e më pas t'i propozojnë Këshillit ndërmarrjen e masave për zbatim të planeve të punës dhe masa tjera për përmbushjen e mandatit të Këshillit. Takimet e rregullta të ekipeve dhe angazhimi i anëtarëve në këto takime rezultojnë në informim më të gjerë mbi rrjedhën e zbatimit të aktiviteteve, sidomos nga përfaqësuesit e institucioneve në këto ekipe, dhe identifikim më të shpejtë të masave të nevojshme për t'u ndërmarrë nga institucionet.

Me qëllim që të rritet gjithëpërfshirja e Shoqërisë Civile në procesin e zbatimit të Strategjisë dhe të mbështetet Këshilli në këtë proces, në vitin 2022 janë themeluar **katër grupe tematike me anëtarë dhe jo-anëtarë të Këshillit dhe aktivistë të Shoqërisë Civile**, bazuar në katër objektivat strategjike të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Këto grupe janë themeluar nga Platforma Civikos, me mbështetje të Programit për Angazhim Qytetar, një partneritet mes KCSF dhe USAID në Kosovë. Roli kryesor i përfaqësuesve të Shoqërisë Civile në këto grupe është që të punojnë në identifikimin e sfidave dhe mangësive kryesore në procesin e zbatimit të Strategjisë, respektivisht problemeve strukturore me të cilat përballen organizatat e shoqërisë civile, dhe në këtë mënyrë të shërbejnë si platformë e cila e fuqizon zërin e Shoqërisë Civile në Kosovë. Këto grupe bashkëpunojnë dhe ndihmojnë Këshillin në identifikimin e sfidave dhe mangësive kryesore lidhur me implementimin e Strategjisë dhe kornizës së përgjithshme ligjore që kanë të bëjnë me një mjedis të favorshëm për zhvillimin e Shoqërisë Civile.

Gjatë vitit 2022, janë organizuar nga katër punëtori për secilin prej grupeve, ku anëtarët gjatë kësaj periudhe kanë punuar në hartimin e rekomandimeve për rritjen e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të objektivave përkatëse të Strategjisë, si dhe kanë analizuar aktivitetet dhe zhvillimet lidhur me Strategjinë, duke përfshirë dhënien e komenteve në koncept-dokumentet përkatëse. Gjatë vitit 2023 janë organizuar nga tri punëtori për secilin prej grupeve, ku krahas identifikimit të sfidave dhe mangësive në zbatimin e Strategjisë, anëtarët gjatë kësaj periudhe kanë finalizuar dhe kanë dërguar tek Këshilli dhe ZQM, rekomandimet e tyre për zbatimin efektiv të aktiviteteve në kuadër të objektivave përkatëse të Strategjisë. Po ashtu, këto ekipe kanë punuar në identifikimin dhe hartimin e rekomandimeve për adresim në strategjinë e re, bazuar në problemet dhe sfidat me të cilat përballen Organizatat e Shoqërisë Civile dhe qytetarët në Kosovë.

### III. SFIDAT E PËRGJITHSHME NË ZBATIMIN E STRATEGJISË

Zbatimi i Strategjisë është përcjellur me sfida të shumta edhe gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023, sfida këto të cilat kanë rezultuar në mosndërmarrjen e aktiviteteve nga ana e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e objektivave të Strategjisë. Sfidat që e kanë përcjellë zbatimin e Strategjisë kanë qenë pothuajse të njëjta që nga fillimi (viti 2019) e deri në vitin e fundit të saj (2023).

Ndërrimi e shpeshtë i përbërjes së institucioneve apo riformatimi i Qeverisë e ka ndikuar për një kohë të gjatë procesin e zbatimit të Strategjisë, duke rezultuar kështu në paqartësi në aspektin e përgjegjësisë në kryerjen e detyrave që ndërlidhen me aktivitetet e Strategjisë. Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, krahas aktiviteteve të definuara, janë përcaktuar institucionet përgjegjëse për zbatim të tyre. Me riformatimin e Qeverisë është bërë shuarja e po ashtu fuzionimi i disa ministrive dhe kjo ka bërë që përgjegjësitë e institucioneve në raport me zbatimin e objektivave të Strategjisë të mos jenë të qarta dhe si rezultat të mos ndërmerren aktivitetet.

Si rezultat i ndërrimit të shpeshtë të sekretarëve të ministrive, apo mosemërimit të tyre, pjesëmarrja e sekretarëve në takimet e Këshillit ka qenë e ulët. Sipas vendimit për themelimin e Këshillit, përfaqësuesit e Qeverisë në Këshill emërohen nga institucionet përkatëse, të cilat përfaqësohen në nivel të sekretarëve të përgjithshëm dhe drejtorëve përgjegjës. Ndërkaq, në shumë raste, përfaqësimi i institucioneve në takimet e Këshillit është bërë nga zyrtarët e deleguar për pjesëmarrje të cilët jo çdoherë ka qenë të njëjtit dhe kjo e ka vështirësuar kontinuitetin e punës së Këshillit.

Në anën tjetër, Pandemia COVID-19 e ka vështirësuar mjaft shumë procesin e zbatimit të Strategjisë, duke pasur parasysh faktin se komunikimi dhe mbajtja e takimeve ka qenë më vështirë e realizueshme në këtë periudhë, sidomos gjatë vitit 2020.

Lëvizjet e anëtarëve të Këshillit (qoftë nga institucionet apo Shoqëria Civile) kanë qenë mjaft të shpeshta, sidomos në vitet e para të zbatimit të Strategjisë. Ndonëse pas vitit 2022 nuk ka pasur lëvizje të anëtarëve të Këshillit, pjesëmarrja e tyre në takimet e Këshillit dhe në përgjithësi në procesin e identifikimit të mangësive në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë dhe avokimit për zbatim të aktiviteteve ka qenë mjaft e ulët.

Po ashtu sfidat tjera si: mungesa e ndarjes së mjeteve buxhetore për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë, dhe mungesa e kapaciteteve njerëzore në numrin e stafit të ZQM-së e kanë shoqëruar gjithë procesin e zbatimit të Strategjisë. Përveç mandatit si Sekretariat i Këshillit dhe obligimeve për koordinimin e aktiviteteve të Këshillit, sipas Planit të Veprimit, ZQM është institucion udhëheqës për implementimin e 15 aktiviteteve në kuadër të katër objektivave të Strategjisë si dhe si institucion mbështetës për implementimin 11 aktiviteteve në kuadër të objektivave. Në këtë mënyrë, ZQM ka qenë e ngarkuar me aktivitete të shumta në kuadër të zbatimit të Strategjisë, të cilat përfshijnë përgatitjen e raporteve vjetore për konsultimet publike, raporteve vjetore për financimin publik të OSHC-ve, përgatitjen e raporteve vjetore të zbatimit të Strategjisë, organizimin e takimeve të Këshillit dhe takimeve të ekipeve të Këshillit etj. Kjo paraqet një barrë mjaft të madhe për ZQM-në duke pasur parasysh kufizimet që ka ky institucion në resurset njerëzore pasi me të gjitha këto përgjegjësi numri i stafit të angazhuar në këtë zyrë vazhdon të mbetet i njëjtë (numri total i zyrtarëve në këtë institucion është nëntë, ndërsa vetëm tre prej tyre e mbulojnë procesin e zbatimit të Strategjisë).<sup>8</sup> Gjithashtu, mungesa e ndarjes së buxhetit ka ndikuar në moszbatim të aktiviteteve të Strategjisë, ku një prej aktiviteteve që nuk është zbatuar ende si rezultat i mungesës së ndarjes së mjeteve është rekrutimi i zyrtarit për koordinimin e procesit të konsultimeve publike.

<sup>8</sup> ZQM mbulon edhe fusha tjera të cilat nuk janë pjesë e Strategjisë

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky raport pasqyroj të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të katër objektivave strategjike të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 për periudhën korrik-dhjetor 2023 në veçanti, duke përmbledhur edhe të gjeturat nga monitorimi i Strategjisë që nga fillimi i zbatimit të saj.

Të gjeturat kryesore tregojnë se edhe gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023 nuk ka pasur ndryshime të mëdha në zbatueshmërinë e aktiviteteve të parapara në kuadër të Strategjisë. Progresi më i madh vërehet në aktivitetin që ndërlidhet me rregullimin e kriterëve dhe procedurave për kontraktim të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve, që përbën një zhvillim mjaft të rëndësishëm dhe përmbajtësor qoftë në aspektin e rregullimit të kornizës ligjore të kësaj fushe e po ashtu në nivelin e zbatimit të Objektivit 3 të Strategjisë.

Sa i përket objektivave tjera, zhvillimet në Objektivin 1 dhe Objektivin 2 janë kryesisht vazhdimësi e proceseve të filluara në periudhat e kaluara.

Ndërkaq, Objektiv 4 i cili mbulon fushën e vullnetarizmit, edhe në këtë periudhë nuk karakterizohet me asnjë aktivitet të zbatuar plotësisht.

Duke u bazuar në të gjeturat e këtij raporti, rekomandimet për veprim të mëtutjeshëm janë si në vijim:

**Rekomandim 1:** Institucionet përgjegjëse për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë të jenë më aktive në zbatim të tyre, pra të marrin përgjegjësi dhe hapa konkret në drejtim të realizimit, e sidomos në përmbjlljen e proceseve që ndërlidhen me aktivitetet të cilat përfshijnë zhvillimin e legjislacionit, krijimin e sistemeve apo mekanizmave të ndryshëm të zbatimit të tyre. Në këtë mënyrë, ministritë përgjegjëse për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë të reflektojnë përgjegjshmëri më të lartë në raport me kryerjen e obligimeve të caktuara me Strategji.

**Rekomandim 2:** Këshilli duhet të jetë më aktiv në përcjelljen e zbatimit të aktiviteteve nga ana e institucioneve. Në këtë mënyrë do të sigurohej identifikim më i shpejtë i mangësive e rrjedhimisht masave që duhet ndërmarrë në drejtim të përmbjlljes së proceseve.

**Rekomandim 3:** Qeveria e Republikës së Kosovës të ndajë buxhet për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë sipas obligimeve të marra me Strategji. Ministritë dhe institucionet tjera përkatëse të jenë në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Financave për t'u siguruar që të ndahet buxheti i nevojshëm për zbatim të aktiviteteve të Strategjisë. Ndarja e buxhetit u mundëson institucioneve që të zbatojnë aktivitetet të cilat bartin me vete kosto financiare, sidomos në rastet kur ato janë të vazhdueshme, siç është p.sh. rekrutimi i zyrtarit për koordinimin e procesit të konsultimeve publike.

**Rekomandim 4:** Të rritet kapaciteti i resurseve njerëzore të ZQM-së në mënyrë që të sigurohet zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë, veçanërisht të mundësohet rekrutimi i zyrtarit për koordinimin e procesit të konsultimeve me publikun. Kjo do të rezultonte në koordinim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm, gjë që kontribuon në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Shoqërisë Civile dhe institucioneve.



## SHTOJCA I. ZBATIMI I OBJEKTIVIT STRATEGJIK 1: RRITJA E PJESËMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKË-BËRJE<sup>1</sup>

Objekti specifik 1.1 Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultimet me publikun						
Aktivitetet	Produkti (Output)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
1.1.1 Ofrimi i njohurive mbi Rregulloren për standardet minimale për konsultime me publikun	Tri sesione informuese për ministritë dhe komunat e përzgjedhura të realizuara Raporti për trajnimet i publikuar	<b>2019-2021:</b> Në dhjetor 2020, ZQM/ZKM në bashkëpunim me IKAP kanë realizuar trajnim për shërbyes civil nga niveli qendror e lokal për konsultimet me publikun dhe platformën online për përfshirjen e publikut në politikë-bërje. Në këtë trajnim është prezantuar sistemi dhe metodologjia e konsultimeve me publikun, rregullorja, platforma dhe monitorimi e raportimi për rrjedhën e konsultimeve me publikun. Pra janë certifikuar 10 Trajner për konsultimet me publikun. MAPL, konform mandatit të saj ligjor në vitin 2018 ka hartuar Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Me qëllim të informimit sa më të mirë të komunave, institucioneve ndër-ministrorë, Organizatave të Shoqërisë Civile, mediet, si dhe akterëve të tjerë, MAPL ka zhvilluar konsultime publike me shkrim dhe në mënyrë elektronike. MAPL në bashkëpunim me partnerët (USAID) ka organizuar 5 sesione informuese me komunat dhe ministrinë, ku zyrtarët komunal janë informuar për obligimet dhe përgjegjësitë që kanë dalë nga ky udhëzim.	<b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave nga ZQM, sesionet informuese janë realizuar. Nuk ka të dhëna nëse është publikuar raporti për trajnimet për vitin përkatës. <b>2022:</b> Raport vjetor: Trajnimi dhe Aftësimi i Nëpunësve Civil Janar-Dhjetor 2020. Instituti i Kosovës për Administratë Publike. 12.09.2022. Instituti i Kosovës për Administratë Publike. Linku në gjuhën shqipe: <a href="https://ikap.rks-gov.net/media/09f93879-53b4-4000-8e57-8fc194bf2fc7.pdf">https://ikap.rks-gov.net/media/09f93879-53b4-4000-8e57-8fc194bf2fc7.pdf</a>			

<sup>1</sup> Me ngjyrë të gjelbër janë hijezuar aktivitetet plotësisht të zbatuara, me ngjyrë të kaltër aktivitetet pjesërisht të zbatuara, me ngjyrë të verdhë aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.



<p>1.1.2 Vendosja e rregullave dhe standardeve për konsultimet me publikun në nivel lokal</p>	<p>Standardet dhe rregullat për konsultime me publikun të miratuara dhe në funksion</p>	<p><b>2019-2021:</b> Është lansuar “Korniza për Përmirësimin e Zbatimit të Standardeve Minimale për Konsultimet Publike 2021-2025”.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Korniza për Përmirësimin e Zbatimit të Standardeve Minimale për Konsultimet Publike 2021-2025. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit.</p> <p>05.11.2021. Platforma Online për Konsultimet me Publikun. Linku në gjuhën shqipe: <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/News/KORNIZA%20-SHQIP.pdf">https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/News/KORNIZA%20-SHQIP.pdf</a></p>			
<p>1.1.3 Ofrimi i një Programi trajnues për institucionet Qeveritare qendrore dhe lokale për metodat e përfshirjes së OSHC-ve në hartimin e politikave</p>	<p>Programi trajnues për institucionet Qeveritare për metodat e përfshirjes së OSHC-ve në hartimin e politikave i finalizuar dhe i shpërndarë Realizimi i 9 sesioneve trajnuese për ministri dhe komuna të përzgjedhura.</p>	<p><b>2019-2021:</b> ZQM në bashkëpunim me IKAP dhe me përkrahjen e projektit të AT të BE-së, gjatë 2020 kanë organizuar dhe ofruar Programin e trajnimit të trajnerëve (ToT) për konsultimet publike. Në vitin 2019 ZQM bashkë me IKAP-in, ka zhvilluar trajnimin në fushën Administratës dhe Legjislacion më temën “Procesi i konsultimit me publikun” me dy grupe të pjesëmarrësve. Grupi i parë me 02-03 prill 2019, dhe grupi i dytë me 15 -16 prill 2019. Gjithashtu ZQM/ZKM bashkë me IKAP-in dhe MAPL me 09 dhe 10 shtator 2019 kanë realizuar rundin tjetër të trajnimeve - Procesi i konsultimit publik në nivel lokal, ku pjesë e tij kanë qenë pesë komuna me nga 6 zyrtarë. Më 1 Dhjetor 2020 ZQM ka organizuar takim me koordinatorët për konsultime me publikun në ministrinë e linjës. ZQM/ZKM, me 14-15 dhjetor 2020 në bashkëpunim me IKAP ka realizuar trajnim për shërbyes civil nga niveli qendror e lokal për konsultimet me publikun. IKAP bashkë me ekipin e Trajnerëve të certifikuar dhe ZQM/ZKM kanë ftuar nëpunës të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal që të marrin pjesë në trajnimin online “Procesi i konsultimit me publikun”. Trajnimet janë organizuar për 2 grupe të pjesëmarrësve me datat 26 dhe 27 Prill 2021, edhe me datat 29 e 30 Prill 2021. Organizimi i trajnimeve online ka vazhduar me ToT e certifikuar edhe me data 17 dhe 18 Maj 2021 - Grupin e Parë dhe Grupin e dytë me datat 24 dhe 25 Maj 2021.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave, është zhvilluar Programi i trajnimit të trajnerëve (ToT) për konsultimet publike dhe janë organizuar sesionet trajnuese.</p>			

<p>1.1.4 Avancimi dhe rritja e përdorimit të Platformës Online për konsultime me publikun</p>	<p>Platforma online e përmirësuar. Udhëzuesi i uebit i zhvilluar dhe përdorur nga institucionet shtetërore</p>	<p><b>2019-2021:</b> Zyra për Qeverisje të Mirë në platformën online për konsultimet me publikun ka filluar në vitin 2020, mirëpo sidomos 2021 ka punuar në përditësimin e të dhënave për institucionet e edhe për koordinatorët përgjatë gjithë kohës së pandemisë si dhe ndryshimit të vendimeve të Kuvendit për institucionet Qeveritare, korrigjimin e platformës dhe mirëmbajtjen e saj me të dhëna të reja. Një ndër pikat kryesore ku është ndërhyrë është kuantifikimi dhe gjenerimi i raporteve statistikore në lidhje me pjesëmarrjen e palëve të treta në proceset konsultative si dhe matjen e performancës së ministrive apo agjencive të ndryshme Qeveritare në përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. <b>2022:</b> Gjatë vitit 2022, është punuar në lehtësimin e qasjes në dokumentet publike për personat me aftësi të vecanta. Në dhjetor 2022, ka filluar publikimi i videove duke përmbledhur përmbajtjen e dokumenteve në proces të konsultimit publik, për personat e shurdhër, me vështirësi në të dëgjuar dhe personat e verbër. <b>Janar-qershor 2023:</b> Zyra për Qeverisje të Mirë është duke punuar në avancimin e mëtutjeshëm të platformës, specifikisht në krijimin e aplikacionit mobil të platformës.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Platforma e Online për Konsultime Publike. Zyra për Qeverisje të Mirë, në Zyrën e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës. Linku në gjuhën shqipe: <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/">https://konsultimet.rks-gov.net/</a> <b>2022:</b> Video promovionale për Platformën Online për Konsultime. Zyra për Qeverisje të Mirë, në Zyrën e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës. 12 dhjetor, 2022. Platforma e Konsultimeve Publike. Linku në gjuhën shqipe: <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/singlePost.php?Post=70017">https://konsultimet.rks-gov.net/singlePost.php?Post=70017</a> <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41689">https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41689</a></p>			
<p>1.1.5 Ofrimi i trajnimeve në vendin e punës për ministrinë e përzgjedhura në përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike</p>	<p>Trajnimet në vendin e punës për 7 ministri e përzgjedhura në përgatitjen e raporteve mbi rezultatet e konsultimeve publike te realizuara</p>	<p><b>2019-2021:</b> Gjatë vitit 2019, seanca janë zhvilluar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përderisa mbështetje është ofruar edhe për Ministrinë e Drejtësisë. Edhe gjatë vitit 2020-2021 Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit kanë vazhduar bashkëpunimi me ministrinë, komunat dhe shoqërinë civile sa i përket mbarëvajtjes dhe përmirësimit të procesit të konsultimeve publike. Ministrive dhe jo vetëm, por edhe Komunave, ju është ofruar mbështetje e vazhdueshme nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë përmes informatave të përditshme, përgjigje dhe sqarime siç është kërkuar nga ata. <b>Janar-qershor 2023:</b> ZQM ka vazhduar të ofrojë përkrahje për institucionet qendrore dhe lokale duke ofruar informata dhe sqarime për përgatitjen e raporteve dhe përdorimin e platformës online për konsultimet publike.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave, trajnime/mbështetje janë ofruar për 4 ministri.</p>	<p>Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët publik për konsultimet me publikun përmes Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) bashkë me ekipin e Trajnerëve të certifikuar dhe ZQM/ZKM kanë vazhduar dhe po vazhdojnë trajnime qoftë në ekipe e edhe në zyra e institucione përgjegjëse për konsultimet publike.</p>		

1.1.6 Organizimi i sesioneve trajnuese praktike për shfrytëzimin efektiv të Platformës Online	5 Sesione trajnuese me Ministrinë dhe komunat	<p><b>2019-2021:</b> Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me Institutin e Administratës Publike –IKAP për dy ditë radhazi me 14 dhe 15 dhjetor 2020, ka realizuar trajnim për ngritje të kapaciteteve të shërbyesve civile nga niveli qendror e lokal për konsultimet me publikun dhe platformën online për përfshirje në politikë bërje. Për të vazhduar bashkë me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ku janë ftuar nëpunës të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal që të marrin pjesë në trajnimin online: Procesi i konsultimit me publikun me 2 (dy)grupe të pjesëmarrësve me datat 26,27 Prill 2021, dhe 29,30 Prill 2021.</p> <p>Organizimin e trajnimeve online ka vazhduar edhe me ToT e certifikuar me data 17 dhe 18 Maj 2021 Grupin e Parë dhe Grupin e dytë me date: 24 dhe 25 Maj 2021.</p>	<b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave, sesionet trajnuese janë organizuar.	Ngritja e kapaciteteve ka dhe përkrahja për zbatimin e rregullores ka vazhduar gjatë gjithë kohës për zyrtarë në nivel qendror e lokal. Kjo ka ndodhur në vend pune, në komunikim online e edhe në trajnime. ZQM bashkë me MAPL në shtator (07-08 shtator 2023) ka realizuar trajnimin Trajnimin “Konsultimi publik në komuna dhe procesin e Publikimit në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovë”.		
1.1.7 Organizimi i takimeve koordinuese për ministrinë dhe zyrat e kryeministrit	6 takime të realizuara	<p><b>2019-2021:</b> Gjatë vitit 2019 janë organizuar tri takime koordinuese të ministrive dhe ZQM/ZKM-së. ZQM me 27 maj 2021 ka realizuar takim pune me IKAP-in dhe kanë punuar në plotësimet e planit kalendarik për trajnimet për konsultimet me publikun dhe për financim publik të OJQ-ve. Me 21 korrik 2021 është realizuar takim i përbashkët me koordinatorët për konsultime në ministri. Po ashtu, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, ka realizuar takim pune me përfaqësues të MAPL për t’u koordinuar dhe diskutuar për procesin e avancimit dhe shtrirjes së konsultimeve publike edhe për nivelin lokal.</p>	<b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave, takimet koordinuese janë organizuar.			

1.1.8 Publikimi i raporteve vjetore të monitorimit mbi zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun ne nivel qendror dhe lokal	Raportet vjetore të monitorimit të publikuara në kohë dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores	<b>2019-2021:</b> Në përputhje me kërkesat e Rregullores, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me të gjitha ministrinë dhe institucionet tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit për të katërtin vit me radhë ka përgatitur raportet vjetore për konsultimet me publikun. Kërkesës së Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit për raportim nga ana e ministrive të dërguar me datë 22 shkurt 2021 i janë përgjigjur 13 ministri prej 15 sa janë, si dhe Zyra e Kryeministrit.	ZQM ka përgatitur dhe publikuar raportet vjetore të monitorimit mbi zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun ne nivel qendror dhe lokal, për vitet: 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Raporti Vjetor për Konsultimet me Publikun në Qeverinë e Republikës së Kosovës për Vitin 2022. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. Mars, 2023. Platforma Online për Konsultime Publike. Linku në gjuhën shqipe: <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-645b4128e5f52.pdf">https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-645b4128e5f52.pdf</a>		Raporti për vitin 2023 përgatitet dhe publikohet në pjesën e parë të vitit 2024.	
1.1.9 Publikimi i praktikave më të mira të konsultimit me institucionet shtetërore dhe komunat	Praktikat më të mira të mbledhura, publikuara dhe të promovuara nëpër institucionet qendrore dhe lokale.	<b>2019-2021:</b> MAPL në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ka themeluar 'Forumit Konsultativ për Qeverisje Lokale' me qëllim të involvimit të tyre në politikat publike. Gjatë takimeve me organizatat e shoqërisë civile janë diskutuar edhe temat rreth praktikave më të mira të konsultimit publik në nivel qendror dhe lokal. Për më shumë shih: <a href="https://mapl.rks-gov.net/forumi-konsultativ-per-Qeverisje-lokale/">https://mapl.rks-gov.net/forumi-konsultativ-per-Qeverisje-lokale/</a>	<b>2019-2021:</b> Nuk ka të dhëna nëse praktikat më të mira janë publikuar dhe promovuar.			
1.1.10 Rekrutimi i një zyrtari për koordinimin e procesit të konsultimeve me publikun	Zyrtari i ri është rekrutuar dhe në punë	<b>2019-2021:</b> Gjatë kësaj kohe dhe në periudha të shkurta ZQM/ZKM është përkrahur nga projekte dhe donatorët e ndryshëm, projekti TACSO.	<b>2019-2021, 2022:</b> Sipas të dhënave, rekrutimi i zyrtarit nuk është bërë. <b>Janar-qershor 2023:</b> Kanë filluar të mbahen takimet në mes të Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Zyrës së Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së rreth rregullores për riorganizim të brendshëm të Qeverisë, me qëllim që të përfshihet rekrutimi i një zyrtari për koordinim të procesit të konsultimeve publike.	Gjatë kësaj kohe dhe në periudha të shkurta ZQM/ZKM është përkrahur nga projekte dhe donatorët e ndryshëm, projekti TACSO.		

**Objektivi specifik 1.2 Ngritja e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike**

Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
1.2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie të komunikimit me publikun për Platformën Online dhe standardet për konsultimet me publikun	Strategjia e komunikimit me publikun e zhvilluar, publikuar dhe plotësisht në funksion	<b>2019-2021:</b> Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit gjatë vitit 2020 e ka filluar fushatën informuese për Platformën Online për Konsultimet me Publikun dhe Standardet minimale për përfshirje të qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Është përgatitur edhe një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultime Publike.	<b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave ZQM gjatë vitit 2020 ka filluar fushatën informuese për Platformën Online për Konsultimet me Publikun dhe Standardet minimale për përfshirje të qytetarëve në politikë-bërje dhe vendimmarrje. Po ashtu me mbështetje të donatorëve, është përgatitur një Strategji e komunikimit me publikun mbi platformën Online dhe standardet e konsultimeve publike. Strategjia nuk është publikuar.	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit prej vitit 2020 e deri tash ka filluar e po vazhdon fushatën informuese për Platformën Online për Konsultimet me Publikun dhe Standardet minimale për përfshirje të qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Është përgatitur një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultimet Publike (tutorial) i cili u bën thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që të përdorin Platformën Online për konsultime publike. Ky tutorial gjithashtu edhe e shpjegon se si shoqëria civile dhe publiku mund të përfshihen në platformë dhe të komentojnë.		

1.2.2 Zhvillimi i një fushate për ngritjen e vetëdijes për standardet e konsultimit me publikun	Udhëzuesi për shfrytëzimin e platformës online për konsultime me publikun nga OSHC-të dhe qytetarët i zhvilluar dhe i shfrytëzueshëm	<b>2019-2021:</b> Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit duke filluar nga shtatori 2020, ka avancuar modalitetet në platformën për konsultime dhe përmes platformës, uebfaqes dhe rrjeteve sociale, ka zhvilluar dhe po zhvillon një fushatë informuese për Platformën Online për Konsultimet Publike dhe Standardet Minimale për përfshirjen e qytetarëve në politikë bërje dhe vendimmarrje. Është përgatitur një udhëzues për përdorimin e Platformës Online për Konsultimet Publike (tutorial) i cili u bën thirrje qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë që të përdorin Platformën Online për konsultime publike. Ky tutorial gjithashtu edhe e shpjegon se si shoqëria civile dhe publiku mund të përfshihen në platformë dhe të komentojnë.	<b>2019-2021:</b> Udhëzuesi është përgatitur dhe publikuar			
	3 Video spotet në platformën online të zhvilluara dhe të transmetuara në TV dhe radio stacionet më të mëdha, si dhe përmes rrjeteve sociale		<b>2019-2021:</b> Video spotet janë përgatitur dhe shpërndarë			
	Dizajnimi, shtypja dhe shpërndarja e fletushkave për platformën online		<b>2019-2021:</b> Fletushkat janë përgatitur dhe shpërndarë			

**Objektivi specifik 1.3 Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike**

Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
1.3.1 Mbajtja e sesioneve informuese për rritjen e kapaciteteve të OSH-Cve për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike	Sesionet informuese të mbajtura për 5 qendra rajonale (Pejë, Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren)	<b>2019-2021:</b> Edhe pse Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka organizuar dhe realizuar takime edhe me OSHC-të për ti informuar për procesin e konsultimeve me publikun, platformën për konsultime dhe detajet për qasje në platformë, ajo që duhet të theksohet është se gjatë kohës që po raportohet nuk janë realizuar trjanimet e sesioneve informuese vetëm për OSHC-të për të kontribuar në procesin e konsultimeve publike.	<b>Janar-qershor 2023:</b> Nuk ka të dhëna nëse institucionet përgjegjëse kanë organizuar sesionet informuese nëpër komunitetet e Kosovës. KCSF, nëpërmjet Qendrës Burimore, ka ofruar trajnime dhe sesione informuese për shoqëritë civile lidhur me shfrytëzimin e mekanizmave formal për pjesëmarrje qytetare.	Bashkëpunim i donatorëve dhe organizatave që janë pjesë e Këshillit dhe zbatimit të Strategjisë – psh. në dhjetor 2023, ka pasur trajnime për qëllim ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve lokale dhe aktivistëve lokalë për të monitoruar implementimin e standardeve minimale të konsultimit publik në komuna. Ky proces do të përfshijë 16 OJQ dhe aktivistë lokalë, të cilët do të përfshihen në 8 rajone në gjithsej 38 komuna. Gjatë trajnimit u shpjeguan konceptet bazë të përfshirjes dhe aspekti ligjor në Kosovë, si dhe u stimulua procesi i monitorimit nëpërmjet përdorimit të metodologjisë, të cilën KLGI e ka hartuar gjatë këtij viti.	Nuk ka të dhëna nëse janë organizuar sesionet informuese nga ana e institucioneve. Ndërkohë, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ), në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar ka filluar me aktivitetet për procesin e monitorimit të standardeve minimale të konsultimit publik në nivel lokal. Rrjedhimisht, janë përzgjedhur organizatat	

					dhe aktivistët që do të angazhohen në monitorim dhe procesi ka filluar në fund të vitit. Së paku 28 komuna nga 8 rajone do të përfshihen në monitorim.
--	--	--	--	--	--



## SHTOJCA II. ZBATIMI I OBJEKTIVIT STRATEGJIK 2: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR FINANCIM NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË OSHC-ve ME INTERES PUBLIK<sup>2</sup>

Objektivi specifik 2.1 Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OSHC-ve						
Aktivitetet	Produkti (Output)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
2.1.1 Zhvillimi i programit trajnues për ministrinë dhe komunat për zbatimin e Rregullores dhe për vlerësimin e propozimeve të projekteve dhe programeve të OSHC-ve për ministrinë dhe komunat	Programi i trajnimit i zhvilluar dhe realizimi i sesioneve trajnuese dhe punëtorive për vlerësimin e projekteve/ programeve të organizatave të shoqërisë civile në nivel qendror dhe lokal	<b>2019-2021:</b> Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe me përkrahjen e projektit të AT të BE-së, gjatë 2020, kanë organizuar dhe ofruar Programin e trajnimit të trajnerëve (ToT) për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Janë certifikuar dymbëdhjetë (12) Trajner për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.	<b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave, është zhvilluar dhe organizuar Programi i trajnimit të trajnerëve.	Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave kanë ofruar përkrahje për institucionet publike, për ministrinë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve dhe programeve të OSHC-ve, raportimin dhe planifikimin të financimit publik të OJQ-ve. Trajnimet janë të domosdoshme gjatë gjithë kohës sepse ndërrohen zyrtarët, kanë nevojë për përkrahje ndërkohë sa publikojnë e përgatisin thirrje publike, raporte vjetore e monitorim të thirrjeve.		

<sup>2</sup> Me ngjyrë të gjelbër janë hijezuar aktivitetet plotësisht të zbatuara, me ngjyrë të kaltër aktivitetet pjesërisht të zbatuara, me ngjyrë të verdhë aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.

<p>2.1.2 Ofrimi i trajnimeve në vend të punës dhe mentorimi (duke përfshirë edhe rolin mbikëqyrës) për ministrinë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financim publik të projekteve dhe programeve të OSHC-ve</p>	<p>Realizimi i trajnimeve në vendin e punës dhe mentorimi i dhënë për së paku 9 ministri dhe 15 komuna</p>	<p><b>2019-2021:</b> Gjatë vitit 2019 janë organizuar seanca trajnuese në punë mbi standardet e financimit për komunat e Mitrovicës së Jugut, Dragashit, Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit. Janë organizuar dy punëtori trajnuese specifike (7 Nëntor 2019 dhe 29 Janar 2020) për vlerësimin e projekteve/programeve të OJQ-ve me qëllim të përmirësimit të shkathtësive dhe kompetencave të ministrive të linjës dhe komunave në këtë fushë thelbësore të ciklit të financimit publik. Më 26-27 dhe 28-29 qershor 2021 janë zhvilluar dy seanca trajnuese fillestare (dy ditore) për financimin publik të OJQ-ve. <b>Janar-qershor 2023:</b> ZQM ka vazhduar të ofrojë përkrahje për institucionet qendrore dhe lokale duke ofruar informata dhe sqarime për procesin e financimit publik të OSHC-ve.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave, janë organizuar 9 seanca/punëtori trajnuese, prej të cilave 5 janë organizuar nëpër komuna.</p>			
<p>2.1.3 Organizimi i takimeve bashkërenduese për ZKM, ministrinë dhe komunat për planifikimin e përbashkët dhe raportimin për financimin publik të OSHC-ve</p>	<p>Takime koordinuese të mbajtura, se paku 5 sosh.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Gjatë vitit 2019 janë organizuar dy sesione informuese për përgatitjen e Raportit për financimin e OJQ-ve për vitin 2018 nga institucionet qendrore dhe lokale, më 6 mars është organizuar takim për ministrinë e linjës, ndërsa më 7 mars takim me komunat. ZQM bashkë me projektin TACSO dhe ekspertët e angazhuar nga projekti me 9 dhe 10 dhjetor 2021 kanë realizuar sesione informuese për zyrtarë të nivelit qendror e lokal për planifikimin dhe raportimin e financimit publik për OSHC-të. ZQM me 23 shkurt ka realizuar takim të përbashkët me Drejtorin e Thesarit dhe koordinatoren e projektit TACSO për Kosovë, që si qëllim kishte bashkëpunimin dhe koordinimin për harmonizim dhe përfshirjen e të gjitha të dhënave në raportin vjetor për përkrahjen financiare që kanë dhënë institucionet për OJQ-të gjatë vitit 2020. ZQM me 27 maj 2021 ka realizuar takim pune me IKAP-in dhe kanë punuar në plotësimet e planit kalendarik për trajnimet për konsultimet me publikun dhe për financim publik të OJQ-ve.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave, takimet koordinuese/sesionet informuese janë realizuar.</p>			

<p>2.1.4 Publikimi i raporteve vjetore për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë</p>	<p>Raportet vjetore të publikuara në kohë dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores</p>	<p><b>2019-2021:</b> Raporti për vitin 2021 është përgatitur dhe publikuar sipas rregullores ku secili ofruer i mbështetjes financiare dërgon raport te ZKM. Platforma e Financimit Publik i është nënshtruar një përmirësimi për të mundësuar raportimin hierarkik i administruar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe me shumë përdorues tjerë konkretisht nga të gjitha Ministritë dhe Komunitet e Kosovës si dhe njësitë përkatëse të tyre tashmë po raportojnë direkt në platformë.</p>	<p><b>2019-2021:</b> ZQM ka përgatitur dhe publikuar raportet vjetore për financimin publik të OSHC-ve për vitet: 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Raport Vjetor për Mbështetjen Financiare Publike për Organizatat Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës për Vitin 2022. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit. Maj, 2023. Platforma Qendrore për Financimin Publik të OJQ-ve. Linku në gjuhën shqipe: <a href="http://ojqfinancime.rks.gov.net/epcontent/uploads/2023/07/RaportiVjetor2022.pdf">http://ojqfinancime.rks.gov.net/epcontent/uploads/2023/07/RaportiVjetor2022.pdf</a></p>		<p>Raporti për vitin 2023 përgatitet dhe publikohet në pjesën e parë të vitit 2024. Organizata jo-Qeveritare Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar ka realizuar monitorimin e financimit publik të OSHC-ve për vitin, ku raporti është publikuar në nëntor të vitit 2023. Në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm do të fillojë procesi i monitorimit për vitin 2023. Raporti i monitorimit të financimit publik të OJQ-ve. KLGJ. 2023. Linku: <a href="https://www.klgi-ks.com/ep-content/uploads/2023/11/Raporti-i-monitorimit-te-financimit-publik-te-OJQ-ve-ALB.pdf">https://www.klgi-ks.com/ep-content/uploads/2023/11/Raporti-i-monitorimit-te-financimit-publik-te-OJQ-ve-ALB.pdf</a></p>	
---	--	---	---	--	--	--

<p>2.1.5 Përmirësimi i bazës qendrore të të dhënave për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë. <a href="http://ojqfinancime.rks-gov.net">ojqfinancime.rks-gov.net</a></p>	<p>Platforma qendrore online e të dhënave për financimin publik të OSHC-ve e zhvilluar dhe tërësisht funksionale</p>	<p><b>2019-2021:</b> Është përmirësuar baza e të dhënave qendrore online për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë. Tash mund të gjenden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OSHC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, etj. <b>2022:</b> Nga viti 2022, është mundësuar raportimi direkt në platformë si dhe ka filluar publikimi i të dhënave për fondet nga donatorët ndërkombëtarë.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Platforma Qendrore Qeveritare për Financimin Publik të Organizatave të Shoqërisë Civile në Republikën e Kosovës. Zyra për Qeverisje të Mirë, në Zyrën e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës. Linku në gjuhën shqipe: <a href="http://ojqfinancime.rks-gov.net/">http://ojqfinancime.rks-gov.net/</a> <b>2022:</b> Baza e të Dhënave e Financimit të OJQ-ve. Zyra për Qeverisje të Mirë, në Zyrën e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës. Platforma qendrore Qeveritare për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile në Republikën e Kosovës. Linku në gjuhën shqipe: <a href="http://ojqfinancime.rks-gov.net/lista-e-hollesishme/">http://ojqfinancime.rks-gov.net/lista-e-hollesishme/</a></p>			
<p>2.1.6 Rishikimi i Manualit për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OSHC-ve</p>	<p>Manuali i rishikuar dhe përditësuar në bazë të komenteve dhe te gjetjeve nga Ministritë, Komunitat dhe OSHC-të</p>	<p><b>2019-2021:</b> Në vitin 2022 do të iniciohet një rishikim i rregullores aktuale të financimit publik të OJQ-ve, për të adresuar pengesat kryesore të identifikuar gjatë viteve të zbatimit të saj dhe bashkë me të do të rishikohet edhe manuali. <b>Janar-qershor 2023:</b> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka raportuar që rregullorja aktuale e financimit publik të OJQ-ve do të ndryshohet pas aprovimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike. Më pas, do të bëhet edhe rishikimi i manualit.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Nuk ka të dhëna për aktivitete konkrete gjatë periudhës 2019-2021</p>	<p>MFPT është në proces të rishikimit të Manualit dhe Rregullores. Rishikimi i Rregullores është në Planin e Akteve Nënligjore të Ministrisë dhe për të njëjtin ka grup punues të themeluar. Rrjedhimisht, kjo nënkupton se përgjatë këtij viti, do të rishikohen dispozitat e Rregullores dhe do të iniciohet plotësim/ndryshimi i saj.</p>		

2.1.7 Rritja e rolit mbikëqyrës të MF-së në zbatimin e Rregullores	Letra qarkore e dërguar nga MF (Dep. e Buxhetit) për zbatimin e Rregullores për ministritë	<b>2019-2021:</b> Departamenti i Buxhetit gjatë komunikimit me Organizata Buxhetore vazhdimisht kërkon të zbatohet Rregullorja për financimin e OJQ-ve.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka informacion nëse letra qarkore është dërguar nga MF. <b>2022:</b> Në dhjetor 2022 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka përgatitur dhe dërguar tek institucionet Qarkoren për zbatimin e Rregullores për Financimin Publik të OJQ-ve			
2.1.8 Krijimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet OB dhe OSHC-ve lidhur me ciklin e financimit të OSHC-ve për financat publike (planifikimi, ekzekutimi dhe auditimi)	Konsultimet publike mbi planin vjetor të thirrjeve publike nga niveli qendror dhe lokal për financimin e OSHC-ve të realizuara duke përfshirë planifikimin, ekzekutimin dhe monitorimin	<b>2019-2021:</b> Është në vazhdimësi duke u përmirësuar sistemi i planifikimit dhe raportimit dhe auditimi i financimit publik të OJQ-ve. Platforma përveç që do të jetë një dritare për publikimin e planeve për financim të fondeve që institucionet ndajnë për OSHC-të, në fazën tjetër ajo mund dhe planifikohet të adaptohet dhe lidhet drejtpërdrejtë edhe me bazën e të dhënave të donatorëve ndërkombëtarë që financojnë OSHC-të në Kosovë, e cila aktualisht menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë.		Është në vazhdimësi duke u përmirësuar sistemi i planifikimit dhe raportimit dhe auditimi i financimit publik të OJQ-ve. Platforma përveç që do të jetë një dritare për publikimin e planeve për financim të fondeve që institucionet ndajnë për OSHC-të, në fazën tjetër ajo mund dhe planifikohet të adaptohet dhe lidhet drejtpërdrejtë edhe me bazën e të dhënave të donatorëve ndërkombëtarë që financojnë OSHC-të në Kosovë, e cila aktualisht menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë. Kjo realisht është edhe kërkesë e Zyrës së BE-së.		

## Objektivi specifik 2.2. Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave

Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
2.2.1 Të rishikohet korniza ligjore e përkufizimit dhe rregullimit të filantropisë (duke përfshirë dhurimet, harmonizimin e fushave të OBP-së)	Koncept dokumentet për krijimin e një kornize ligjore gjithëpërfshirëse për filantropinë të përgatitura	<b>2019-2021:</b> Ndonëse, disa nisma fillestare janë ndërmarrë në nivelin e diskutimeve në vitin, nuk ka ndryshime në legjislacion në lidhje me filantropinë individuale dhe atë të korporatave. Nuk ka progres që duhet të vlerësohet. Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmeve institucional për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave është planifikuar që të zbatohet në bashkëpunim me ATK, FIQ dhe Projektin e AT-së dhe duhet të punohet gjatë viti 2022.	<b>2022:</b> Në prill të vitit 2022 është mbajtur takimi i parë i Forumit joformal të Filantropisë, duke shënuar kështu themelimin e Forumit në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, një përpjekje e përbashkët e KCSF dhe misionit të USAID në Kosovë për të ofruar një platformë që mundëson diskutimin sistematik të çështjeve dhe veprimeve për të sjellë një ekosistem më të favorshëm ligjor dhe praktik për filantropinë në Kosovë.  Një analizë e kornizës ligjore dhe rregullative për filantropinë në Kosovë është duke u zhvilluar nga KCSF në bashkëpunim me European Center for not-for-Profit Law, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar. Analiza ka qasje gjithëpërfshirëse dhe shumë-shtresore të pengesave kryesore që pengojnë zhvillimin e filantropisë, ofron praktika krahasuese evropiane dhe propozon zgjidhje specifike për çështjet e identikuara.		Analiza e kornizës ligjore dhe rregullative për filantropinë në Kosovë e cila është duke u zhvilluar nga KCSF në bashkëpunim me European Center for not-for-Profit Laë, në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, është në proces të përmbylljes. Gjetjet dhe rekomandimet do të diskutohen me akterët relevant.	

			Analiza do të shërbejë si bazë për të nisur dialog politikash që promovon kulturë të dhurimeve individuale për kauza të së mirës publike.			
2.2.2 Dizajnimi dhe zhvillimi i programit/ sistemit trajnues për zyrtarët e tatimit për praktikën vendore dhe ndërkombëtare të administrimit të përfitimeve tatimore për filantropinë individuale dhe të korporatave	Programi trajnues i dizajnuar dhe zhvilluar dhe mbajtja e sesione trajnuese.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka progres dhe rrjedhimisht në linjë të aktivitetit paraprak shtyhet për vitin tjetër.				
2.2.3 Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave	Përgjegjësitë institucionale për monitorimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore dhe të politikave për filantropinë të përkufizuara Personeli përkatës i trajnuar nga institucionet përgjegjëse për politikën e filantropisë	<b>2019-2021:</b> Ky aktivitet do të realizohet në vitin 2022. Nuk ka progres.				
2.2.4 Fushatat informuese për biznese dhe qytetarë për mundësinë që individët ose korporatat ofrojnë për filantropinë	Fletëpalosjet e dizajnuara dhe të shtypura (1000 kopje) Fletëpalosjet e shpërndara te qytetarët dhe bizneset	<b>2019-2021:</b> Nuk ka progres.				

**Objektivi specifik 2.3. Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të**

Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
<p>2.3.1 Krijimi i standardeve, procedurave, kriterëve dhe mekanizmave institucional transparent për rregullimin e dhënies së pronave shtetëror në shërbim të OSHC-ve</p>	<p>Standardet dhe Procedurat janë hartuar dhe miratuar</p>	<p><b>2019-2021:</b> Është miratuar Ligji nr. 06/l-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Rregullorja (QRK) – Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të cilat rregullojnë procedurat, kriteret si dhe mekanizmat transparentë për rregullimin e alokimit të pronës komunale për përdorim nga OSHC-të.</p>	<p><b>2019-2021:</b> Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. 03.04.2019.</p> <p>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.</p> <p>Linku në gjuhën shqipe: <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18917">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18917</a></p> <p><b>2022:</b> Gjatë vitit 2022 MAPL ka filluar procesin e plotësimit/ndryshimit të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, mirëpo ky është një aktivitet shtesë krahas aktiviteteve të realizuara.</p> <p><b>Janar-qershor 2023:</b> Koncept Dokument për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. 15.12.2022. Platforma Online për Konsultime Publike.</p> <p>Linku në gjuhën shqipe: <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41689">https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41689</a></p>		<p>Projektligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës është miratuar nga ana e Qeverisë në muajin dhjetor.</p>	



2.3.2 Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/ sistemi trajnues për shërbyesit civil mbi përdorimin e standardeve dhe procedurave për rregullimin e dhënies së pronës publike në shfrytëzim të OSHC-ve	Trajnimi i dizajnuar dhe i zhvilluar për zbatimin e standardeve dhe procedurave	<b>2019-2021:</b> Pas miratimit të Ligjit nr. 06/l-092 dhe Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 janë organizuar trajnime për të sqaruar procedurat për dhënien e pronës komunale duke përfshirë edhe OSHC-të. Gjithashtu është hartuar edhe një Qarkore ku u është shpërndarë komunave lidhur me procedurat e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim shkresë njoftuese për komuna lidhur me procedurat e kthimit të pronave të menxhuar nga AKP në pronësi të komunave.				
2.3.3 Zhvillimi i Regjistrimit Elektronik të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim të OSHC-ve	Regjistri Elektronik i përgatitur dhe funksional	<b>2019-2021:</b> Ligji nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Rregullorja (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e kanë paraparë që komunat janë të obliguar që të publikojnë listen e pronave komunale që planifikojnë të ipen në shfrytëzim, kjo listë duhet të publikohet në faqen e komunës respektive. <b>Janar-qershor 2023:</b> Gjatë muajit qershor, MAPL ka konfirmuar se do ta përfshijë krijimin e Regjistrimit elektronik të pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim për OSHC-të në platformën e-komunat.	<b>2019-2021:</b> Edhe pse sipas informatave nga ZQM, komunat në bazë të Ligjit dhe Rregullores përkatëse për këtë fushë janë të obliguar ta publikojnë listën e pronave komuna që jepen në shfrytëzim, nuk ka të dhëna apo informata nëse është zhvilluar regjistri elektronik i pronave shtetërore të dhëna në shfrytëzim për OSHC-të.		Krijimi i regjistrimit tashmë është përfshirë si pjesë e procesit të avancimit të platformës e-komunat, proces ky për të cilin ende janë duke u zhvilluar procedurat përkatëse nga ana e MAPL-së.	
<b>Objektivi specifik 2.4. Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të financuara nga BE-ja</b>						
<b>Aktivitetet</b>	<b>Produkti (Output)</b>	<b>Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023</b>	<b>Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023</b>	<b>Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023</b>	<b>Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023</b>	<b>Niveli i zbatimit</b>
2.4.1 Krijimi i mekanizmit financues në Ministrinë e Integritimit për Bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE për OSHC-të	Mekanizmi i financimit është krijuar dhe është funksional	<b>2019-2021:</b> Nuk ka progres.				

2.4.2 Vendorsja e standardeve, procedurave dhe mekanizmave institucional për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja	Analiza e praktikave të mira në bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja i përgatitur Standardet dhe procedurat e miratuara dhe institucioni përgjegjës me buxhetin përkatës është vendosur.	<b>2019-2021:</b> Zbatimi në zhvillim e sipër. Janë duke u realizuar diskutimet fillestare.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka të dhëna konkrete për këtë proces	Janë duke u realizuar diskutimet fillestare.		
2.4.3 Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi/ sistemi trajnues për shërbyesit civil dhe OSHC-të për përdorimin e standardeve dhe procedurave për bashkëfinancimin e projekteve të OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja	Programi i trajnimit i dizajnuar dhe zhvilluar për personelin përkatës të institucioneve përgjegjëse.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka progres.				
2.4.4 Mbajtja e sesione informuese për OSHC-të për mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve të mbështetura nga BE-ja	5 sesione informuese të mbajtura në rajonet kryesore.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka progres.				
2.4.5 Rekrutimi i zyrtarit të ri për koordinimin e procesit të financimit publik të OSHCve	Zyrtar i ri i rekrutuar dhe në punë.	<b>2019-2021:</b> Është bërë transferimi i një zyrtari të ish-MIE te Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit.				

## SHTOJCA III. ZBATIMI I OBJEKTIVIT SRATEGJIK 3: ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE PËR KONTRAKTIMIN E OSHC-VE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE<sup>3</sup>

Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OJQ-ve						
Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
3.1.1 Konsolidimi i kornizës së përgjithshme ligjore, duke përfshirë legjislacionin tatimor, në lidhje me aktivitetet ekonomike të OSHC-ve	Hartimi i një analize të politikave për dispozitat që duhet të adresohen Përgatiten Korniza ligjore është konsoliduar (posaçërisht Ligji për Tatimin në të Ardhura të Korporatave) Korniza ligjore është në zbatim	<b>2019-2021:</b> Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim. <b>Janar-qershor 2023:</b> MFPT ka raportuar se legjislacioni tatimor është në proces të ndryshimit.	<b>Janar-qershor 2023:</b> Nuk ka të dhëna nëse ndryshimet ndërlidhen direkt me aktivitetet ekonomike të OSHC-ve.			
3.1.2 Përgatitja e Udhëzimeve për zbatimin e kornizës së konsoliduar ligjore me raste studimore	Udhëzimet janë përgatitur	<b>2019-2021:</b> Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.				
3.1.3 Organizimi i sesioneve informuese për shërbyesit civil, duke përfshirë zyrtarët tatimor, për t'i informuar ata për ndryshimet në kornizën ligjore	Tri sesione informuese të mbajtura	<b>2019-2021:</b> Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.				

3 Me ngjyrë të gjelbër janë hijezuar aktivitetet plotësisht të zbatuara, me ngjyrë të verdhë aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.

**Objektivi specifik: 3.2. Përmirësimi i njohurive të institucioneve rreth mundësive (modeleve) ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve**

Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
3.2.1 Finalizimi i vlerësimit të nevojave për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të në fusha të ndryshme të punës	Vlerësimi i nevojave i formuluar për të vendosur standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të	<b>2019-2021:</b> Aktualisht MFPT njihet si institucion që i mbështet OSHC-të në ofrimin e shërbimeve. Pika e nisjes, krahas nevojës për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit, duhet të jetë krijimi i bazës së të dhënave për OSHC-të të cilat janë ofrueset e shërbimeve. Gjithashtu Platforma Civikos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit është në proces të finalizimit të vlerësimit të nevojave të organizatave që ofrojnë shërbime në kuadër të projektit “Mitigating the impact of the COVID-19 pandemic on CSOs providing services mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, financuar nga German Marshall Fund -USAID.	<b>2022:</b> Platforma Civikos në kuadër të projektit “Zbutja e ndikimit të pandemisë COVID-19 të OSHC-të që ofrojnë shërbime”, në partneritet me European Center for Not for-Profit Law(ECNL) dhe me Zyrën për Qeverisje të Mirë, si dhe financuar nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe USAID, ka përgatitur dokumentet si në vijim: “Hartëzimi dhe Sfidat e Organizatave të Shoqërisë Civile në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë”; “Dokument i Politikave Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OSHC-të”; dhe “Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OJQ-të”.			
3.2.2 Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi trajnues për shërbyesit civil për të mësuar rreth kornizës ligjore dhe modelet ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike	Trajnimi është dizajnuar dhe zhvilluar për kornizën ligjore dhe modelet ekzistuese për kontraktimin e OSHC-ve  Mbajtja e 6 sesioneve të trajnimeve për kontraktim të OSHC-ve	<b>2019-2021:</b> Ky aktivitet ndërlidhet me ndryshimin e legjislacionit.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka të dhëna nëse trajnimi është dizajnuar dhe zhvilluar			

3.2.3 Lansimi fushatës për informim publik për OSHC-të rreth mundësive për të ndihmuar Qeverinë të ofrojë shërbime publike	Fushata e informimit publik e përgatitur 8 sesioneve të informimit publik të mbajtura	<b>2019-2021:</b> Zyra për Qeverisje të Mirë ka qenë pjesë e aktivitetit që Fondi për Zhvillim Komunitar – CDF, në kuadër të Programit të financuar nga granti i Fondit Global kanë iniciuar diskutimin dhe procesin e krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të financimit publik të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), për të ofruar shërbime shëndetësore parandaluese të bazuara në komunitet, në kuadër të Programeve kombëtare për HIV dhe TB. Kontraktimi social është mekanizëm i financimit publik të OSHC-ve i cili konsiderohet si faktor esencial në reagimin e qëndrueshëm dhe efektiv ndaj HIV dhe TB, dhe dëshmon kapacitetin e Qeverisë për të siguruar vazhdimësinë e zbatimit të këtyre shërbimeve të ofruara nga OSHC-të edhe pas tranzicionit nga mbështetja financiare e donatorëve.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka të dhëna nëse janë mbajtur sesionet e informimit publik			
<b>Objekti i specifik 3.3. Përmirësimi i legjislacionit që rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të</b>						
<b>Aktivitetet</b>	<b>Produkti (Output)</b>	<b>Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023</b>	<b>Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023</b>	<b>Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023</b>	<b>Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023</b>	<b>Niveli i zbatimit</b>
3.3.1 Krijimi i një baze të të dhënave me të gjithë informacionin e nevojshëm për OSHC-të të cilat ofrojnë shërbime publike dhe OSHC-të e mundshme të cilat mund të bëhen ofrues të shërbimeve	Dizajni i databazës i kompletuar Databaza është lansuar Të gjitha OSHC-të janë regjistruar si ofrues të mundshëm të shërbimeve publike	<b>2019-2021:</b> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve posedon një liste të OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale. Po ashtu Ministria e Shëndetësisë ka një liste të OJQ-ve që ofrojnë shërbime shëndetësore. Ish MPMS, tanimë Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, disponon dhe ka në dispozicion listën e OJQ-ve të licencuara për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel vendi. Nr. i OJQ-ve të licencuara ka arritur në 49 OJQ. Gjithashtu Platforma Civikos është në proces të grumbullimit të të dhënave për OSHC-te që ofrojnë shërbime.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka të dhëna nëse është dizajnuar dhe kompletuar databaza.			

**Objektivi specifik 3.4. Përmirësimi i legjislacionit që rregullon standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të**

Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
3.4.1 Krijimi i standardeve, procedurave dhe kritereve për rregullimin e ofrimit të shërbimeve publike nga OSHC-të	Standardet dhe Procedurat janë hartuar dhe miratuar	<b>2019-2021:</b> Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.		MFPT ka krijuar grupin e punës për hartimin e draft rregullores për shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile.	Në dhjetor të vitit 2023 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka themeluar grupin punues për hartimin e Rregullores për Kontraktim të Shërbimeve të OSHC-ve, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të OSHC-ve. Takimi i parë i grupit punues është mbajtur në muajin dhjetor. Aktivitetet e grupit punues realizohen nga Platforma Civikos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë, në kuadër të projektit Human Rightivism, i mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë përmes Fondit për Zhvillim Komunitar (CDF).	

<p>3.4.2 Përgatitja e Manuali Online me udhëzime për kontraktimin e OSHCve për ofrimin e shërbimeve publike, në bazë të kornizës ligjore të ndryshuar</p>	<p>Doracaku me udhëzime për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike është përgatitur dhe shpërndarë, në bazë të kornizës ligjore të ndryshuar Manuali i publikuar në ueb faqe</p>	<p><b>2019-2021:</b> Nuk ka pasur aktivitete specifike për këtë veprim.</p>				
---	---	---	--	--	--	--



## SHTOJCA IV. ZBATIMI I OBJEKTIVIT STRATEGJIK 4: RITJA E VULLNETARIZMIT PËR PROGRAMET ME INTERES PUBLIK<sup>4</sup>

Objektivi specifik 4.1. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik						
Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
4.1.1 Të hartohet dhe miratohet Koncept Dokumenti mbi Vullnetarizmin	Koncept dokumenti për rregullimin dhe promovimin e vullnetarizmit i përgatitur Rekomandimet e koncept dokumentit mbi vullnetarizmin dhe masat të tjera të nevojshme të miratuara Rekomandimet e koncept dokumentit janë miratuar duke siguruar zbatimin e qëndrueshëm	<b>2019-2021:</b> Koncept Dokumentit për Vullnetarizëm është në proces të finalizimit dhe tashmë është duke u punuar në përmbylljen e tij. Ky proces u diskutua edhe me rastin e ditës së Rinisë në korrik të 2020 dhe bashkë me OJQ-të pjesëmarrëse jemi pajtuar që ky draft të jetë sa më shpejt për konsultim paraprak dhe publik. Për të kontribuar në proces të finalizimit të Koncept Dokumentit për Vullnetarizëm, drafti është ndarë me OJQ-të që punojnë në fushën e vullnetarizmit. Në tetor 2021 bashkë me OJQ LENS jemi në përmbyllje të dokumentit dhe shumë shpejt do të procedohet për konsultim paraprak e publik dhe aprovim në Qeveri. <b>Janar-qershor 2023:</b> ZQM është në koordinim me TACSO-n, të cilët gjatë këtij viti do ta përkrahin ZQM-në me ekspertizë që të finalizohet koncept dokumenti.	<b>2019-2021:</b> Edhe pse një koncept-dokument për vullnetarizëm është përgatitur dhe ndarë me OJQ-të që punojnë në këtë fushë, rekomandimet nga ky koncept-dokument nuk janë të miratuara. <b>2022:</b> Gjatë vitit 2022 KCSF së bashku me organizatën TOKA kanë filluar zhvillimin e një hulumtimi rreth vullnetarizmit në Kosovë, i cili ka për qëllim që të nxjerrë rekomandime dhe zgjidhje konkrete mbi përmirësimin e ekosistemit të vullnetarizmit në Kosovë.	ZQM është në proces të analizimit final të koncept dokumentit aktual dhe hulumtimit mbi praktikën më të mira.	Hulumtimi mbi vullnetarizmin në Kosovë nga KCSF dhe TOKA është finalizuar. Në periudhën vijuese do të identifikohen mundësitë për promovim dhe angazhim në vullnetarizëm dhe do të diskutohen me palët relevante.	
4.1.2 Implementimi i rekomandimeve nga Koncept dokumenti	Koncept dokumenti për rregullimin dhe promovimin e vullnetarizmit i përgatitur Rekomandimet e koncept dokumentit mbi vullnetarizmin dhe masat të tjera të nevojshme të miratuara	<b>2019-2021:</b> Ky aktivitet do të realizohet në rrjedhë të aktivitetit paraprak dhe duhet të shtyhet për 2022.				

<sup>4</sup> Me ngjyrë të verdhë janë hijezuar aktivitetet në proces të zbatimit ndërsa me ngjyrë të kuqe aktivitetet e pazbatuara.

	Rekomandimet e koncept dokumentit janë miratuar duke siguruar zbatimin e qëndrueshëm					
<b>Objektivi specifik 4.2. Zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të rekrutuar, angazhuar dhe menaxhuar vullnetarët</b>						
<b>Aktivitetet</b>	<b>Produkti (Outputi)</b>	<b>Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023</b>	<b>Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023</b>	<b>Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023</b>	<b>Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023</b>	<b>Niveli i zbatimit</b>
4.2.1 Lansimi i një skeme të granteve për financimin e aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve për OSHC-të për menaxhimin efektiv të vullnetarëve	Skema e granteve e publikuar dhe 4-5 OSHC të kontraktuara për të ofruar programe trajnimi për menaxhimin efektiv të vullnetarëve në komunitetet e tyre lokale Ligjet e nevojshme të ndryshuara; Gazeta zyrtare; faqet e internetit të ZQMZKM; Raportet mbi zbatimin e strategjisë	<b>2019-2021:</b> Nuk është realizuar.				
4.2.2 Përgatitja e një Manuali me udhëzime për rekrutimin dhe menaxhimin e vullnetarëve	Manuali me udhëzimet për angazhimin e vullnetarëve i përgatitur dhe shpërndarë, në bazë të ndryshimeve të kornizës ligjore Manuali i publikuar në ueb faqen e ZQM/ZKM-së.	<b>2019-2021:</b> Nuk është realizuar.				

**Objektivi specifik 4.3. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit**

Aktivitetet	Produkti (Outputi)	Rezultatet ZQM, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Civikos, sipas periudhave: 2019-2021; 2022; janar-qershor 2023	Rezultatet ZQM, periudha korrik-dhjetor 2023	Civikos, periudha korrik-dhjetor 2023	Niveli i zbatimit
4.3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë dhe vlerat e vullnetarizmit	Video spoti për rëndësinë e vullnetarizmit i përgatitur dhe i transmetuar në media Fletushkat rreth asaj se si mund të organizohet vullnetarizmi i përgatitur dhe shpërndarë	<b>2019-2021:</b> Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë kanë organizuar takim të përbashkët dhe konferencë për media bashkë me OJQ-të që punojnë me të rinjtë dhe ata që merren me vullnetarizmin me 12 gusht 2019. Zyra për Qeverisje të Mirë –Zyra e Kryeministrit së bashku me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe organizatat; PEN - Peer Educators Netëork / Lens / OSCE Mission in Kosovo/UNICEF/ RYCO/ kanë organizuar konferencë me rastin e Ditës Botërore të Vullnetarizmit me 05 dhjetor 2019.	<b>2019-2021:</b> Sipas të dhënave nga ZQM, ZQM së bashku me disa OJQ dhe donatorët ndërkombëtarë kanë organizuar konferencë me rastin e Ditës Botërore të Vullnetarizmit. Një videospot për rëndësinë e vullnetarizmit është realizuar dhe transmetuar.			
4.3.2 Përmirësimi i regjistrimit Online për vullnetarët e rinj të regjistruar	Regjistri Online i përmirësuar Regjistri Online i përmirësuar dhe tërësisht në përdorim	<b>2019-2021:</b> Për nder të Ditës së Rinisë, Lensi, mbështetur nga OSCE Mission in Kosovo dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ZQM/ZKM kanë prezantuar Platformën Kosovo Youth. Synim i kësaj platforme është punë, punë praktike, trajnime, bursa, grante, dhe shumë mundësi të tjera, të gjitha në një platformë të vetme.	<b>2019-2021:</b> Nuk ka të dhëna nëse platforma është përmirësuar. <b>2022:</b> Sipas të dhënave, Platforma është rifunksionalizuar mirëpo ende nevojitet që të mirëmbahet.			



